



Titulli original: *İslâm'ın Cihanşümul Medeniyeti*
BİZİM MEDENİYETİMİZ

Përktheu: Ilir Hoxha; Fatmir Sulaj

Redaktor: Zija Vukaj

Redaktor: Alban Kali

Design: Bledar Xama



PROGRESI sh.p.k. _____

Adresa: Sheshi "2 Prilli" / Rr: Studenti / Shkodër / Shqipëri

Mob: +355 67 60 78484

http: www.progresibotime.com

e-mail: botime@progresibotime.com

Adresa Kosovë: Rr: Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin / Prizren

Tel: +381 29 222 795

Fax: +381 29 222 797

e-mail: kosova@progresibotime.com

Adresa Maqedoni: Rr: Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25 / Shkup

Tel: +398 71 956 271

e-mail: maqedoni@progresibotime.com



QYTETËRIMI ISLAM

Osman Nuri TOPBASHI

PROGRESI
BOTIME



Parafjalë

Falënderimet dhe lavdet e pafundme i takojnë Allahut të Madhëruar...

Salatet dhe selamet e pafundme i takojnë Profeti tonë të nderuar (a.s.)...

Ditët dhe stinët e asaj lindjeje të bekuar, na ndihmojnë ta kujtojmë edhe më shumë atë mirësi të madhe që na është falur, pra, faktin se jemi ume-ti i të Dërguarit të fundit të Allahut të Madhëruar...

Sot, për shkak të islamofobisë dhe në sajë të disa intrigave, po përpiqen t'i atribuojnë Islamit atë që është e kundërta e tij, terrorizmin dhe vrasjen. Disa qarqe, po përpiqen qëllimisht ta prezantojnë në mënyrë të gabuar të Profetin tonë të das-



hur (a.s.), me qëllim që të devijojnë njerëzimin. Ata po tentojnë të baltosin dritën e shpalljes hyjnore. Për rrjedhojë, është shumë e rëndësishme dhe e domosdoshme ta njohim atë nga afër.

Të kuptosh luftën e tij ndaj terrorit të injorancës drejtuar njeriut, krijesave, e madje edhe bimëve dhe, t'ia tregosh këtë gjithë njerëzimit, është detyra e çdo besimtari mysliman.

Të mësosh moralin e tij të mrekullueshëm, frymën shpirtërore në adhurimin e tij, delikatesën në veprat e tij, mirësjelljen në moralin e tij, butësinë në zemrën e tij, bukurinë e ndritur në fytyrën e tij, rrjedhshmërinë në gjuhën e tij, hollësitë në ndjenjat e tij dhe thellësinë në shikimin e tij, duke marrë hise prej frymëzimit të tij shpirtëror dhe duke dëshiruar të jesh bashkë me të në të gjitha fazat e jetës, për ne është në nivelin e vaxhibit/detyrës.

Epoka e lumturisë, periudha e kalifëve të drejtë, koha e Omer bin Abdulazizit dhe tre shekujt e parë të Perandorisë Osmane, janë të mbushur plotë me shembuj të qytetërimit të virtyteve që u ngjrit prej moralit të tij dhe, në të njëjtën kohë edhe të qytetërimit tonë (Osman).

Qytetërimi ynë, me arkitekturën e tij, me letërsinë, vakëfet, komplekset rreth xhamive, institucionet bamirëse, teqetë të cilat ishin si qendra të rehabilitimit shpirtëror dhe më e rëndësishmja, me njerëzit që edukoi, njerëzit e shërbimit dhe njerëzit e vakëfit, është një qytetërim i jashtëzakonshëm.

Ndërsa sot, në emër të qytetërimit, në botë ek-



ziston vetëm një qytetërim barbar i maskuar. Ekziston një mbizotërim i materiales që e ka bërë teknologjinë mjet të mizorisë.

Për këtë arsye, njerëzimi ka nevojë për qytetërimin e vërtetë, për qytetërimin që ndërtoi i Dërguari i Allahut, për qytetërimin Islam...

Në një ajet fisnik, urdhërohet:

“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun...”

(Ali-Imran, 110)

I lutem Allahut të Madhëruar që kjo të jetë e dobishme dhe të pranohet si një përpjekje e vogël e shprehjes së falënderimit që jemi umeti i të Dërguarit të Tij (a.s.).

Suksesi është prej Allahut!



Osman Nuri Topbash
Dhjetor 2015, Stamboll



NJERËZIMI
KA NEVOJË PËR
ATË MORAL
dhe QYTETËRIM
MADHËSHTOR



*Morali i tij madhështor është busulla e udhëzimit që
të shpie te pëlqimi i Allahut...*



NJERËZIMI KA NEVOJË PËR ATË MORAL DHE QYTETËRIM MADHËSHTOR

MORALI QË KËSHILLON KURANI

Allahu i Lartësuar thotë:

وَإِنَّكَ لَعَلَىٰ خُلُقٍ عَظِيمٍ

“Me të vërtetë, ti je me virtyte madhore.” (Kalem, 4)

Allahu i Madhëruar është i vetmi mësues dhe edukator i të Dërguarit të Allahut (a.s.). Atë e ka edukuar Zoti (xh.sh.). Morali i tij i pashoq është kriter real dhe shembulli më ideal për njerëzimin.



Allahu i Madhëruar thotë:

لَقَدْ كَانَ لَكُمْ فِي رَسُولِ اللَّهِ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ لِّمَن كَانَ
يَرْجُو اللَّهَ وَالْيَوْمَ الْآخِرَ وَذَكَرَ اللَّهَ كَثِيرًا

“Në të Dërguarin e Allahut është shembulli i mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit, prandaj e përmend shumë Allahun.”

(Ahzab, 21)

Morali i tij madhështor është busulla e udhëzimit që të shpie te pëlqimi i Allahut Teala, është çelësi i paqes e i lumturisë në këtë botë dhe i shpëtimit e i Xhenetit në botën tjetër.

Morali madhështor është një kandil udhëzimi që shkëlqen, një llambë ndriçuese që largon çdo lloj errësire.

Ne kemi nevojë për atë moral.

Ne duhet t’ia reflektojmë edhe njerëzimit atë moral madhështor në formë pasqyrash të pastra, duke e përjetuar vetë dhe duke i bërë edhe të tjerët ta përjetojnë, sepse:

NJERËZIMI KA NEVOJË PËR ATË

Meqë gjendemi në atmosferën e qetë të përkujti-

Allahu i Lartësuar thotë:

“Me të vërtetë, ti je me virtyte madhore.”

(Kalem, 4)





mit të ditëlindjes së të Dërguarit të Allahut (a.s.), do të ishte me vend t'i përmendnim disa shembuj nga madhështia e moralit të tij dhe ta kontrollonim jetën tonë, duke e peshuar me moralin e Pejgamberit (a.s.).

Ne jemi të detyruar ta shprehim se gjuha jonë është e paaftë për ta përkufizuar plotësisht moralin e moralit të lartë, domethënë, përfaqësuesin më të shkëlqyer të moralit të lartë, burimin e krenarisë së krijesave, atë që ishte dritë nga koka deri tek këmbët, të Dërguarin e Allahut (a.s.).

Ajo që mund të bëjmë është që t'i hedhim disa pika uji fytyrës sonë të etur nga deti i mëshirës së pafundme duke u përpjekur t'i qetësojmë zemrat tona, sado pak qoftë.

Morali i tij ishte Kurani.

Kurani Fisnik është arti më kulmor i Allahut të Madhëruar në fjalën e Tij.

Edhe i Dërguari i Allahut (a.s.), është arti më kulmor i Zotit (xh.sh.), në krijimin e njeriut. Këto dy pasqyra prej drite / fjala dhe krijimi i Zotit (xh.sh.), reflektojnë njëra-tjetrën.

Allahu i Madhëruar thotë:

“O ju që keni besuar! Mos nxitoni (me fjalët dhe veprat tuaja) para (urdhrit të) Allahut dhe të Dërgu-

Morali i tij madhështor është busulla e udhëzimit që të shpie te pëlqimi i Allahut Teala, është çelësi i paqes e i lumturisë në këtë botë dhe i shpëtimit e i Xhenetit në botën tjetër.





arit të Tij (pranojeni si kufi të pacënueshëm urdhrin e Allahut dhe sunetin e të Dërguarit të Allahut) **dhe kijeni frikë Allahun! Vërtet, Allahu dëgjon gjithçka dhe është i Gjithëdijshëm.**” (Huxhurat, 1)

Ndërsa ky hadith fisnik bën komentimin e ajetit të mësipërm:

“Fjala më e bukur është fjala e Allahut. Rruga më e drejtë është rruga e Muhamedit.” (Buhari, I’tisam, 2)

Kjo do të thotë se krahas Librit të Allahut, Suneti dhe morali i lartë i Profetit (a.s.), i japin drejtim jetës sonë dhe janë kriteret për të njohur kufijtë.

Jeta e të Dërguarit të Allahut (a.s.), e cila është shembull për çdo besimtar deri në Ditën e Kiametit, gjithmonë ishte e thjeshtë. Ajo ishte larg ekstremitetit.

Ai, me jetën e ibadetit që e kryente me modesti, na ka treguar përsosmërinë e nënshtrimit ndaj Allahut Teala. Jo vetëm me jetën e ibadetit, por edhe me modelin shembullor si kryefamiljar dhe administrues, me sjelljen e përkushtimit ndaj punës dhe shoqërisë, me pak fjalë, në të gjitha aspektet e jetës, Ai na ndriçon me dritën e tij.

Ja një shembull i vogël nga ajo dritë:

*Morali madhështor është një kandil
udhëzimi që shkëlqen, një llambë ndriçuese
që largon çdo lloj errësire.*





MË MADHËSHTORI, MË BUJARI

Krenaria e Gjithësisë, Profeti (a.s.), na përcjell këtë mesazh përmes një hadithi të tij fisnik:

“Te një besimtar i vërtetë nuk mund të gjenden këto dy cilësi: Koprracia dhe morali i ulët!” (Tirmidhi, Birr, 41/1962)

I Dërguari i Allahut (a.s.), ishte më bujar se erërat. Edhe kur ishte në vështirësi, edhe kur e kishte gjendjen mirë, gjithmonë jepte për hir të Allahut Teala. Në Medine, e cila ishte qendra e shtetit islam, kishte raste që vinin plaçkat e luftës, por i Dërguari i Allahut (a.s.), ua shpërndante ato të varfërve pa e arritur mëngjesin.

Grada më e lartë e bujarisë është dhënia e përparësisë në ndihmë të të tjerëve edhe kur familja e fëmijët e tu janë në nevojë. I Dërguari i Allahut (a.s.), përjetonte kulmin e altruizmit. Nevojave të as’habu’s-suffas, të nxënësve të Kuranit, u jepte përparësi ndaj nevojave të vajzës dhe familjes së tij.

Po të dëshironte mund t’i jepte Ehli Bejtit aq sa t’ua plotësonte të gjitha nevojat, sepse nganjëherë mrekullitë e duarve të tij të bekuara i mbulonin me mirëqenie dhe begati të gjithë. Nganjëherë plaçkat e luftës që vinin me bollëk dhe mundësitë e pafundme që silleshin rreth e rrotull tij, ishin të mjaftueshme, madje tepronin për t’u dhënë pjesëtarëve të familjes së

“Shefaati (ndërmjetësimi) im do të jetë për ata prej umetit tim, të cilët kanë bërë gjynahe të mëdha.”

(Ebu Daud, Sunnet, 20)





tij një jetë pa asnjë vështirësi. Por Ai i jepte përparësi lumturisë së Ahiretit, e cila është jeta e vërtetë. Jepte aq shumë për hir të Allahut, saqë shpesh herë nuk i ngelte asgjë për vete.

Aishja (r.a) thotë:

“Familja e Muhamedit (a.s.), deri në momentin kur Ai ka ndërruar jetë, nuk e ka ngopur barkun me bukë elbi dy ditë radhazi.” (Buhari, Ejman, 22; Muslim, Zuhd, 22; Ibn Maxhe, Et’ime, 48)

Mundësitë materiale ishin vetëm një mjet për t’i mëshiruar krijesat, për ta lartësuar fenë e Allahut dhe për t’i motivuar të tjerët drejt udhëzimit.

Safuan bin Umejje, i cili ishte njëri prej të mëdhenjve të politeistëve kurejshë, u gjend pranë të Dërguarit të Allahut (a.s.), në luftën e Hunejnit dhe të Taifit, edhe pse nuk ishte bërë mysliman.

Ndërkohë që i Dërguari i Allahut (a.s.), po shihte plaçkat e luftës që ishin mbledhur në Xhirane, vuri re se Safuani po e vërente me mahnitje të madhe një pjesë të tyre, prandaj e pyeti:

“A të pëlqeu shumë?”

Ai iu përgjigj: “Po.”

Nisur nga kjo, i tha:

“Merre, le të jetë e gjitha e jotja!”

Nisur nga kjo mirësi, Safuani nuk u përmbajt e tha:

*Mësuesi dhe edukatori i Pejgamberit (a.s.)
ishite vetë Allahu, Ai e edukoi atë.*





“Asnjë zemër nuk mund të jetë kaq bujare përveçse zemra e Pejgamberit.”

Më pas deklaroi shehadetin dhe u bë mysliman.

Ndërsa, kur u kthye tek njerëzit e fisit të tij, iu drejtua atyre:

“O populli im! Nxitoni dhe bëhuni myslimanë, sepse Muhamedi po jep dhe po bën shumë mirësi pa pasur frikë nga varfëria dhe nevoja.” (Muslim, Fedail, 57-58; Ahmed, III, 107.)

MODESTIA MË E SINGERTË

I Dërguari i Allahut (a.s.), edhe pse ishte më i nderuari dhe më i larti i krijesave si “rob dhe i dërguar”, jetonte me një modesti mjaft të singertë. Edhe kur ishte i detyruar për t’i shprehur cilësitë e tij të larta, theksonte:

“Nuk ka lavdërim. Këto nuk i them për t’u lavdëruar.”

Në sajë të modestisë dhe mëshirës së gjerë, i çliroi zemrat e njerëzve nga çdo lloj ambicieje për sërë shoqërore. Shumica e myslimanëve të parë që i besuan atij ishin të dobët, të varfër dhe robër. Sipas këndvështrimit të tij ndaj njerëzimit, midis një fshatari beduin të ardhur nga shkretëtira apo një robi që sapo i

“Familja e Muhamedit (a.s.), deri në momentin kur Ai ka ndërruar jetë, nuk e ka ngopur barkun me bukë elbi dy ditë radhazi.”

(Buhari, Ejman, 22)





ishte falur liria, nuk kishte asnjë ndryshim me njerëzit e pasur dhe prijësit. Ai i jepte përparësi vetëm pjekurisë shpirtërore, domethënë, devotshmërisë.

I Dërguari i Allahut (a.s.), një mëngjes kur sahabët e nderuar ishin pranë tij, u ul në gjunjë te sofrë që ishte përgatitur. Një beduin që e pa këtë sjellje, u habit nga ajo ulje e kulturuar dhe u shpreh i çuditur:

“Çështë kjo ulje kështu?!”

I Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

“Allahu Teala më ka krijuar si një rob të ndershëm, jo si një inatçi dhe shtypës!” (Ebu Davud, Et’ime, 17/3773)

Ai, si falënderim për moralin madhështor që ia dhuroi Allahu i Lartësuar, së pari e përhapi atë moral të lartë në një mënyrë që i la të mahnitur edhe armiqtë e tij. Ai gjithmonë jetoi në një gjendje adhurimi dhe nënshtrimi ndaj Zotit (xh.sh.).

Shembujt më të bukur të modestisë së të Dërguarit të Allahut (a.s.), u dhanë në kohën kur Ai ishte më i fuqishmi dhe më i pushtetshmi.

I Dërguari i Allahut (a.s.), ishte në kulmin e fuqisë dhe pushtetit material. Ai e çliroi Meken me një ushtri të përbërë nga dhjetë mijë sahabë të tij. Atë ditë një bashkëqytetar i frikësuar, i emocionuar dhe që dridhej duke kërcitur dhëmbët, i tha:

“O i Dërguari i Allahut! Ma mëso Islamin!”

“Familja më e mirë ndër myslimanët, është ajo që sillet mirë me jetimin. Ndërsa familja më e keqe ndër myslimanët, është ajo që sillet keq me jetimin.”

(Ibn-i Maxhe, Edeb, 6)





Ai iu përgjigj me butësi duke i kujtuar këtë shembull nga koha kur mundësitë i pati më të pakta:

“Qetësohu vëllai im! Unë nuk jam mbret apo sundimtar. Unë jam jetimi i fqinjës tënde të vjetër prej kurejshve që hante mish të tharë në diell!..”

Modestinë e tij e ndiqte falja dhe mëshira.

FALJA MË SUBLIME

Ai ishte Pejgamberi i mëshirës, prandaj i fali ata që e patën gjuajtur me gurë. I fali edhe ata që patën vrarë Zejneben (r.a.). I fali edhe ata që e torturuan xhaxhain e tij, sepse ai ishte i ngarkuar me detyrë që ta bënte njerëzimin të meritonte faljen e Allahut Teala. Ai ishte një njeri që e donte faljen, sepse Ai mishërohej prej një morali të dhuruar nga Allahu i Madhëruar.

Ditën e çlirimit të Mekës, politeistët kurejshë nuk arritën t’i bënin asnjë rezistencë ushtrisë madhështore të Islamit. Për shkak se nuk kishin asnjë rrugëzgjidhje, u futën në Mesxhidu’l-Haram dhe po prisnin të shqetësuar ndëshkimin për padrejtësitë që bënë përgjatë 20 viteve.

I Dërguari i Allahut (a.s.), i pyeti:

“O populli Kurejsh! O mekas! Çfarë thoni? Çfarë pandehni se do të bëj me ju tani?”

“Te një besimtar i vërtetë nuk mund të gjenden këto dy cilësi: Koprracia dhe morali i ulët!”

(Tirmidhi, Birr, 41/1962)





Kurejshët i thanë:

“Ne mendojmë se do të shfaqësh mirësi dhe do të na trajtosh me mirësi, ndaj themi: ‘Ti do të sillësh me mirësi ndaj nesh.’ Ti je një vëlla i nderuar dhe bamirës. Ti je biri i një vëllai të nderuar dhe bamirës. Tashmë ke arritur fuqinë dhe pushtetin. Na trajto me mirësi!”

Nisur nga kjo, i Dërguari i Allahut (a.s.), u tha:

“Gjendja ime dhe gjendja juaj do të jetë si gjendja e Jusufit dhe gjendja e vëllezërve të tij. Unë po ju them të njëjtat fjalë, siç u tha Jusufi vëllezërve të vet:

“Sot s’ka qortim për ju; Allahu do t’ju falë. Ai është më i mëshirshmi i mëshiruesve!” (Jusuf, 92) (Ibn Hisham, Siret, IV, 32; Vakidi, Megazi, II, 835; Ibn Sa’d, Tabakat, II, 142-143)

Pejgamberi i mëshirës u dërgua në mesin e një-rëzve që jetonin në errësirën e xhahilijetit dhe në një shoqëri agresive e injorante. Përgjatë gjithë jetës si profet, u dhunua dhe u ofendua pa mbarim. Por ai duroi, toleroi dhe shfaqti butësi.

DURIMI DHE BUTËSIA E PAFUNDME

I Dërguari i Allahut (a.s.), shpesh herë merrte borxh për të plotësuar nevojat e nevojtarëve prej umetit. Bilali (r.a.), e tregon kështu sakrificën dhe bujarinë e të Dërguarit të Allahut (a.s.), të cilat kishin arritur pikën më të lartë të altruizmit:

*Ai ishte Pejgamberi i mëshirës,
Ai i fali ata që e patën gjuajtur me gurë.
I fali edhe ata që patën vrarë Zejneben (r.a).
I fali edhe ata që e torturuan xhaxhain e tij.*





“Që nga dita kur është dërguar si profet nga Allahu Teala e deri në ditën që ka ndërruar jetë, shumë punë të Dërguarit të Allahut (a.s.), i kam kryer unë për të. Për shembull, kur i vinte ndonjë mysliman dhe e shikonte se ishte i varfër, më urdhëronte mua që të shkoja dhe të merrja borxh. Pastaj unë shkoja dhe merrja rroba e ushqime për atë...” (Ebu Davud, Haraxh, 33-35/3055)

Marrja borxh e të Dërguarit të Allahut (a.s.), për t’u dhënë të tjerëve, shfaq virtytin e tij për t’u dalë zot nevojtarëve, edhe pse nuk kishte vetë. Kjo na tregon për një moral madhështor dhe është dispozitë në çështjen e marrjes së borxhit.

Ebu Saidi’l-Hudri (r.a.), tregon:

“Një beduin erdhi tek i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe i kërkoi borxhin që kishte për të marrë, por kur e bëri këtë, shfaqti një sjellje agresive. Madje i tha:

“Deri sa të ma paguash borxhin, do vazhdoj të të shqetësoj.”

Sahabët e nderuar e qortuan beduinin dhe i thanë:

“Turp të të vijë! Me sa duket, ti nuk e di se me kë po flet!”

Beduini tha:

“Unë po kërkoj hakun tim.”

I Dërguari i Allahut (a.s.), u tha sahabëve:

“Përse nuk mbani anën e atij që ka për të marrë

Ai ishte i ngarkuar me detyrë që ta bënte njerëzimin të meritonte faljen e Allahut Teala. Ai ishte një njeri që e donte faljen, sepse Ai mishërohej prej një morali të dhuruar nga Allahu i Madhëruar.





të drejtën e tij?” Pastaj dërgoi dikë te Havle binti Kajs dhe i tha:

*“Nëse ke hurma të thata, ma paguaj këtë borxh!
Kur të na vijë hurmat, do të ta kthej borxhin.”*

Havle tha:

“Patjetër! Babai im të qoftë falë, o i Dërguari i Allahut!”

I Dërguari i Allahut (a.s.), ia pagoi borxhin bedunit dhe mbi të gjitha, i dha edhe ushqim për të ngrënë. Beduini, i cili u gëzua nga kjo sjellje, e shprehu lumturinë e tij duke thënë: “Borxhin e pagove në mënyrën më të mirë. Edhe Allahu ta dhëntë shpërblimin e plotë për këtë!”

Nisur nga kjo, i Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

“Ja, këta (që e paguajnë borxhin e tyre ashtu siç duhet), janë njerëzit më të mirë. Një shoqëri, në të cilën të dobëtit nuk mund t’i marrin të drejtat e tyre pa u lënduar, nuk mund të shpëtojë...” (Ibn Maxhe, Sadakat, 17)

Ja një shembull i pashoq i drejtësisë dhe butësisë së të Dërguarit të Allahut (a.s.)...

Ai i shikonte mëkatarët dhe njerëzit e pasjellshëm si zogj të plagosur. Kështu që nuk prekej kurrë prej tyre. Ai përpiqej me butësi për ta larguar umetin nga zjarri i Xhehenemit dhe për ta shpëtuar nga injoranca, sepse ndërjegjja e tij ishte e mbushur plot me ndjenjën e përgjegjësisë.

“Të gjithë jeni cobanë dhe të gjithë jeni përgjegjës për tufën tuaj. Imami është coban dhe përgjegjës për tufën e tij. Burri është cobani i familjes së tij dhe përgjegjës për tufën e tij. Gruaja, është cobane në shtëpinë e burrit të saj dhe po ashtu është përgjegjëse për tufën e saj. Shërbyesi është përgjegjës për pasurinë e pronarit të vet dhe për tufën e vet.” (Buhari, Ahkam 1)





VETËDIJA E PASHOQË PËR PËRGJEGJËSINË

I Dërguari i Allahut (a.s.), e shikonte veten përgjegjës për të gjithë shoqërinë.

Sa dëshmitare fisnike janë këto shprehje të tij për butësinë dhe ndjenjën e përgjegjësisë që kishte ai:

“Unë jam më përpara madje edhe më afër çdo besimtari, se çështë ai me veten e tij. Nëse dikush lë pasuri kur të ndërrojë jetë, ajo pasuri u përket të afërmeve të tij. Por nëse lë borxhe apo jetimë, ai borxh më përket mua. Edhe përkujdesja ndaj jetimëve është detyrë për mua.” (Muslim, Xhuma, 43; Ibn Maxhe, Mukaddime, 7)

I Dërguari i Allahut (a.s.), duke e ngarkuar të gjithë umetin e vet me përgjegjësi ndaj njëri-tjetrit, ka thënë:

“Të gjithë jeni çobanë dhe të gjithë jeni përgjegjës për tufën tuaj (ata që keni nën vete). Imami është çoban dhe përgjegjës për tufën e tij. Burri është çobani i familjes së tij dhe përgjegjës për tufën e tij. Gruaja, është çobane në shtëpinë e burrit të saj dhe po ashtu është përgjegjëse për tufën e saj. Shërbyesi është përgjegjës për pasurinë e pronarit të vet dhe për tufën e vet.” (Buhari, Ahkam 1; Muslim, Imaret 20)

Një çoban, bën kujdes në këto gjëra:

- Çobani e kupton gjendjen shpirtërore të tufës së vet.

Çobani e lëshon tufën e vet në vende ku ka kullotë. Aty e lë të pushojë dhe të hajë dhe, nuk i lëshon në vende të thata. Kështu edhe besimtari i bën ata që ka nën përgjegjësi të qëndrojnë dhe të shërbejnë në rrugën që do t'i çojë drejt mëshirës hyjnore, e jo në rrugën që do t'i largojë prej Allahut.





- Çobani e lëshon tufën e vet në vende ku ka kullotë. Aty e lë të pushojë dhe të hajë dhe, nuk i lëshon në vende të thata.

- Çobani e ruan tufën e vet prej ujqërve dhe egërsirave.

- Çobani, edhe një qengj të sëmurë nuk i la ujqërve, por e merr në gji dhe e fut në tufë.

- Çobani ndonjëherë ecën para, e ndonjëherë pas tufës, duke e kontrolluar tufën për të cilën është përgjegjës.

Gjithashtu, edhe besimtari ka përgjegjësi ndaj atyre që ka nën vete:

- Ai i bën ata që të qëndrojnë dhe të shërbejnë në rrugën që do t'i çojë drejt mëshirës hyjnore, e jo në rrugën që do t'i largojë prej Allahut.

- Ai i ruan ata prej shejtanit, që është edhe armiku i përjetshëm i njeriut.

- Nëse ata gabojnë, ai kujdeset për ta me dhembshuri, si të ishin zogj krahthyer. Ai i ngre ata që bien dhe i mbështet.

Duke i nxitur besimtarët që të kujdesen për të dobëtit e shoqërisë, Profeti (a.s.), thotë:

“Familja më e mirë ndër myslimanët, është ajo që sillet mirë me jetimin. Ndërsa familja më e keqe ndër myslimanët, është ajo që sillet keq me jetimin.” (Ibn-i Maxhe, Edeb, 6)

Allahu i Madhëruar i dha fisnikëri birit të Ademit. Robi duhet të fisnikërohet duke përparuar me adhurime, moral dhe vepra të mira në rrugën e drejtë të të Dërguarit të Allahut (a.s.). Dhe, në këtë mënyrë ai do të bëhet meritator për xhenetin e mrekullueshëm.





Xherir bin Abdullahu (r.a.), tregon:

“Një ditë ishim mbledhur pranë të Dërguarit të Allahut herët në mëngjes. Atë moment ia behu një grup të mjerësh prej fisit Mudar. Në trupat e tyre gjendej një mbulesë e thjeshtë me vija, që i ngjante lëkurës së tigrin. Ata e kishin shpuar në mes këtë mbulesë dhe e kishin futur në kokë. Mirëpo, ishin pothuajse të zhveshur.

Kur i pa ata në një gjendje kaq të varfër, të Dërguarit të Allahut (a.s.), i ndryshoi ngjyra e fytyrës. Ai hyri menjëherë në shtëpinë e tij dhe më pas e urdhëroi Bilalin (r.a.), të thërrasë ezanin. Bilali (r.a.) e thirri ezanin, e më pas ikametin. Pasi Profeti (a.s.), fali namazin, u ngjiti në hutbe dhe këndoi këtë ajet fisnik:

«O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra. Dhe frikësojuni Allahut, me emrin e të Cilit ju kërkoni të drejtat e ndërsjella dhe ruani lidhjet farefisnore. Se vërtet, Allahu është përherë Mbikëqyrës mbi ju.» (Nisa, 1)

Më pas këndoi këtë ajet:

«O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se ç’ka përgatitur për të nesërmen!..»

(Hashr, 18)

Pas kësaj, ai tha:

«Të gjithë të japin sadaka prej arit, argjendit,

Në çfarë harmonie dhe rrjedhshmërie janë fjalët në gjuhët tona? Sa paqe shpërndajnë gjuhët tona ndaj shpirtirave? Sa qetësi u japin fjalët tona atyre që kemi përballë?





veshjeve dhe sado pak qoftë, prej grurit dhe hurmave të tyre. Madje, të japë sadaka edhe në qoftë ajo një gjysmë hurme!»

Pa kaluar shumë, një person prej ensarëve, solli një çantë të rëndë, të cilën nuk e mbante dot. Të gjithë hynë në radhë njëri pas tjetrit për të dhënë sadaka. Në fund, pashë që u bën dy grumbuj me ushqime dhe veshje. Më pas, vura re se të Dërguarit të Allahut po i qeshte fytyra që i shndriste si flori...” (Muslim, Zekat, 69.)

Ndërsa sot, është detyra jonë ta bëjmë të buzëqeshë fytyrën e bekuar të Profetit tonë (a.s.). A e ndjejmë edhe ne përgjegjësinë e jetimëve, të vetmuarve dhe të pashpresëve dhe, a veprojmë në përputhje me atë që kërkon të qenit umet i Profetit tonë (a.s.)?

A përçojnë zemrat tona mëshirë, si Ai? A përhapin gjuhët tona aroma trëndafili, si ai?

Sepse sot, në mënyrë të veçantë harrohet delikatesa e Profetit tonë (a.s.):

MË DELIKAT SE TRËNDAFILAT, MË ORATOR SE BILBILAT

I Dërguari i Allahut (a.s.), ishte një njeri i mbushur me hijeshi, thjeshtësi dhe butësi. Bukuria, madhështia, shkëlqimi dhe thjeshtësia e tij ishin aq të larta, sa që nuk kishte nevojë për ndonjë mrekulli, argument dhe shenjë të veçantë se ai ishte Pejgamberi i Allahut Teala.

Bukuria, madhështia, shkëlqimi dhe thjeshtësia e tij ishin aq të larta, sa që nuk kishte nevojë për ndonjë mrekulli dhe argument tjetër.





Në fytyrë kishte bukuri vezulluese, në fjalë kishte oratori, në sjellje kishte hijeshi, në gjuhë kishte gojëtari, në fjalë kishte rrjedhshmëri dhe në biseda kishte elokuencë. Ai asnjëherë nuk thoshte fjalë të padobishme. Çdo fjalë e tij kishte urtësi dhe ishte këshillë. Në fjalët e tij asnjëherë nuk kishte thashetheme dhe gjëra të pavlera. Gjithmonë fliste sipas aftësisë së perceptimit të të gjithëve. Ishte i butë dhe modest. Asnjëherë nuk qeshte me të madhe duke e tepruar. Gjithmonë buzëqeshte. Ai që e shihte atë befasisht, kaplohej nga frika. Ai që takohej e bisedonte me të, ndjente dashuri në zemër dhe në shpirt.

Të folurit me këshilla të bukura, me fjalë të urta dhe me shembuj për t'i ftuar njerëzit në mirësi dhe për t'ua predikuar atyre Islamin, ishte metoda e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Me mëshirën e gjerë të tij që i përfshinte të gjithë njerëzit dhe për hir të mirësisë, udhëzimit, shpëtimit, virtytit dhe humanizmit, i gjallëronte zemrat si shiu i begatshëm që bie ëmbël-ëmbël dhe rëndë-rëndë. Kur fliste me dikë, nuk kthehej nga ai vetëm me kokën, por me të gjithë trupin e tij.

Ai ishte njeriu që fliste më me oratori, më me koncizitet dhe më me urtësi se të gjithë të tjerët. Ai fliste në mënyrën më përmbledhëse, duke e shprehur në formën më të saktë përmbajtjen dhe qëllimin e tij.

Fjalët mbarojnë dhe boja thahet, por cilësitë e

*Në fytyrën e tij kishte dritë,
në fjalët e tij rrjedhshmëri, në lëvizjet e tij butësi,
në gjuhën e tij oratori, në bisedat e tij qartësi
dhe në ligjërimet e tij kishte një elokuencë
të mrekullueshme.*





Atij Deti të Mëshirës nuk mbarojnë. Rruga më e vyer për t'ua dhënë njerëzve moralin madhështor të Atij është përpjekja për ta përjetuar vetë atë moral të lartë. Për të marrë pjesë nga përshpirtshmëria e tij, duhet ta përjetojmë atë emocion.

Veçoria jonë, duhet të jetë parimi i Profetit (a.s.):

“Njeriu është me atë që do!” (Buhari, Edeb, 96.)

Theubani (r.a.), ishte një rob. Mbase në këtë botë nuk kishte qoftë edhe një pemë apo një çadër. Ai vinte pranë Profetit (a.s.), dëgjonte bisedën e tij, ndikohej prej saj dhe ikte. Më vonë, vinte përsëri, dëgjonte bisedën dhe ndikohej përsëri prej saj.

Një ditë, kur shkoi përsëri, Profeti (a.s.), e pa se ishte shumë i mërzhitur dhe e pyeti:

“Si e ke hallin o Theuban?”

Theubani (r.a.), filloi të tregojë me gjithë shpirt:

“Të qofshin falë nëna, babai dhe kjo jeta ime o i Dërguar i Allahut! Unë ndikohem së tepërmi prej bisedave të tua. Kur shkoj në shtëpi më merr malli shumë. Çdo moment që kaloj larg dritës tënde, për mua është një ndarje më vete... Nëse në këtë botë është kështu, kam frikë se në botën tjetër do të jetë edhe më keq. Atje, ju do të jeni së bashku me profetët e tjerë. Ndërsa unë, nuk është e sigurt se si dhe ku do të jem. Mbi të gjitha, nëse nuk do të hyj në xhenet, do të

*Si është pjekuria shpirtërore e adhurimeve tona?
Pra, a na cojnë adhurimet tona drejt pasionit dhe
thellësisë së ndjenjave? Sa e arrijmë
përkushtimin dhe qetësinë e zemrës?*





privothem plotësisht prej teje. Kjo frikë më djeg e më përcëllon o i Dërguari i Allahut!”

Profeti ynë (a.s.), heshti për pak çaste dhe më pas tha:

“O Theuban! Njeriu është me atë që do.” (Buhari, Edeb, 96; Muslim, Birr, 165)

Duhet të llogarisim se sa e kemi përvetësuar kuptimin e këtij parimi...

Dashurinë tonë duhet ta matim me bashkimin tonë, ndërsa bashkimin tonë duhet ta krahasojmë me dashurinë tonë.

Duhet të pyesim:

Sa kemi përfituar prej botës shpirtërore të Profetit të Allahut (a.s.)?

Sa hise kemi prej jetës, gjendjes shpirtërore dhe personalitetit të asaj drite?

SA KEMI PËRFITUAR NE?

Si është pjekuria shpirtërore e adhurimeve tona?

Pra, a na çojnë adhurimet tona drejt pasionit dhe thellësisë së ndjenjave? Sa e arrijmë përkushtimin dhe qetësinë e zemrës?

*Të arrijmë të hyjmë në xhenet së bashku me të,
varet nga sa jemi të përbashkët në besim, në adhurim,
në moral, në vepra dhe në mënyrën e jetesës.*





Në çfarë niveli është delikatesa e veprave tona?

Sa arrijmë t'i bëjmë zemrat tona vend mëshire? Sa mëshirë shpërndajmë prej atij vendi? A kurorëzohen veprat tona me "Allahu qoftë i kënaqur!", apo përfundojnë me "Të qoftë haram hakun tim!"?

Në çfarë niveli është delikatesa e moralit tonë?

A është delikatesa që shfaqim ndaj të tjerëve në të njëjtin nivel me mirësjelljen që presim prej tyre? A kemi arritur të shpëtojmë prej egoizmit dhe mendjemadhësisë? A është e sinqertë modestia jonë?

Në çfarë thellësie është butësia e zemrave tona?

Sa arrijmë t'i përshijmë në gjirin tonë të gjitha krijesat? Sa kemi arritur t'i bëjmë zemrat tona vend për nevojtarët e të vetmuarit? Sa përfshirëse dhe sa ndikuese është mëshira jonë?

Sa e ndritshme është drita në fytyrat tona?

Sa kemi përfituar ne prej përkufizimit që jepet në ajetin fisnik ku numërohen cilësitë e besimtarëve që janë bashkë me Profetin tonë (a.s.):

سَيَمَاهُمْ فِي وُجُوهِهِمْ مِنْ أَثَرِ السُّجُودِ

"...Në fytyrat e tyre shihen shenjat e sexhdes..."

(Fet'h, 29)

*Në çfarë niveli është delikatesa e veprave tona?
Sa arrijmë t'i bëjmë zemrat tona vend mëshire?
Sa mëshirë shpërndajmë prej atij vendi?*





Në çfarë harmonie dhe rrjedhshmërie janë fjalët në gjuhët tona?

Sa paqe shpërndajnë gjuhët tona ndaj shpirttrave?
Sa qetësi u japin fjalët tona atyre që kemi përballë?

Në çfarë niveli është delikatesa e ndjenjave tona?

A jemi të vetëdijshëm se të gjitha krijesat na janë lënë amanet? Çfarë pjekurie ka kujdesi ynë ndaj ajeteve të Allahut, ndaj përgjegjësive tona dhe ndaj exhelit e kijametit që po afrohen? A na dridhen zemrat? A na lotojnë sytë?

Në cilat horizonte ndodhet thellësia e shikimeve tona?

Sa arrijnë zemrat tona të shohin madhështinë e shfaqjeve hyjnore, fuqinë dhe bukurinë e tyre? Sa e zbatojmë urdhrin “اقْرَأْ/Lexo!”?

Në jetën e tasavufit, një nga treguesit më të rëndësishëm të zhvillimit të zemrës, është edhe përparimi në meditim, sepse tasavuf, do të thotë të pajisesh me moralin e Profetit (a.s.), të marrësh hise prej frymëzimit të tij shpirtëror. Dhe kjo, bëhet shkak që niveli i zemrës të përparojë në ngritje. Si rezultat i përparimit të zemrës, arrihen edhe majat e meditimit.

Atëherë duhet pyetur:

Sa kemi arritur të shpëtojmë prej njohurive sipër-

Sa arrijnë zemrat tona të shohin madhështinë e shfaqjeve hyjnore, fuqinë dhe bukurinë e tyre? Sa e zbatojmë urdhrin “اقْرَأْ/Lexo!”?





faqësore e të thata dhe prej dijes së padobishme? Sa kemi arritur të njohim të fshehtat dhe urtësitë?

Shkurtimisht:

Sa kemi përfituar prej moralit të lartë dhe detit të gjerë shpirtëror të Profetit tonë (a.s.), për të cilin ajeti fisnik shprehet duke e lavdëruar: “(O Muhammed!) Padyshim se ti je me moral të lartë!” (Kalem, 4.)?

Sa gjenden tek ne prej të gjitha bukurive të atij Profeti të lartë, prej zemrës së të cilit rridhte mëshirë për botët?

Dy njerëz i dhanë selam Selmanit dhe e pyetën:

“A je sahab i të Dërguarit të Allahut (a.s.)?”

Ai iu përgjigj: “Nuk e di.”

Të ardhurit dyshuan se mos i ishin drejtuar ndonjë njeriu të gabuar. Selmani (r.a.), e vijoi kështu fjalën e tij:

“Unë e kam parë të Dërguarin e Allahut (a.s.) dhe kam marrë pjesë në kuvendet e tij. Por sahab i vërtetë i të Dërguarit të Allahut (a.s.), është ai njeri që mund të hyjë në Xhenet bashkë me të.” (Hejsemi, VIII, 40-41; Dhehebi, Sijer, I, 549)

Ndërsa hyrja bashkë me Atë në Xhenet, është e lidhur me bashkimin e mënyrës së jetesës sonë me

*Nëse një shoqëri formohet
nga nëna të devotshme dhe lind trima
atëherë fitorja është e jotja.*





jetesën e Atij në besim, ibadet, moral dhe vepra. Nëse sot mund ta perceptojmë dhe gjallërojmë me një vetëdije të tillë ditëlindjen e të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe shumë ditëlindje të tjera të tij, atëherë do të thotë se kemi përfituar siç duhet nga epoka e lumturisë.

Domethënë, ne mund të përfitojmë nga ai duke marrë pjesë nga përsipirtshmëria e tij dhe duke e përjetuar me devotshmëri këtë pjesë.

Allahu i Lartësuar e ka nderuar njeriun. Robi nderohet duke kaluar etapa në drejtim të adhurimit, moralit dhe veprave të mira që gjenden në rrugën e drejtë të të Dërguarit të Allahut (a.s.). Në këtë mënyrë arrihet gjendja e kërkuar dhe sublime për të hyrë në Xhenetin e mrekullueshëm.

Allahu Teala na bëftë prej atyre që jetojnë me këtë përsipirtshmëri!

Zoti (xh.sh.), na bëftë prej robërve që marrin pjesë nga morali i të Dërguarit të Allahut (a.s.)! Gjithashtu, na e mundësoftë dhe lehtësoftë për t'u bërë si vëllezërit e tij, që i merr malli dhe që dëshirojnë ta shohin atë!..

Amin!..



*Shoqëria e kohëve tona ka nevojë
për udhëzimin e trashëgimtarëve të Profetit (a.s.)
dhe njerëzve të devotshëm.*



العَمَلُ وَالْإِيمَانُ
الْمَعْرُوفَانِ

TRASHËGIMTARËT E AMANETIT TË SHENJTË



Trashëgimia e Profetëve është dituria dhe urtësia e tyre. Edukimi i nxënësve me karakter dhe personalitet Islam është amanet i shenjtë.

Një hadith i Profetit (a.s.) thotë:

"Dijetarët janë trashëgimtarë të profetëve."

(Ebu Davud, Ilim,1)

Kurse ajeti Kuranor thotë:

"Allahut i frikësohen vetëm dijetarët." (Fatir, 28)



TRASHËGIMTARËT E AMANETIT TË SHENJTË

EDUKIM DHE ARSIM HYJNOR

Allahu kërkon prej njeriut të kalojë përmes një procesi edukimi dhe arsimit në mënyrë që të meritojë Xhenetin. Pikërisht ky është qëllimi i dërgimit të pejgamberëve dhe librave hyjnorë.

Veçanërisht Muhamedi (a.s.), i cili nuk është dërguar udhëzues vetëm për popullin e tij, por për gjithë njerëzimin deri në Ditën e Kiametit.

Ekukimin e Pejgamberit (a.s.), e ka kryer vetë Krijuesi i gjithësisë. Pastaj edukimin e gjithë njerëzimit ia besoi Pejgamberit (a.s.).



Ai, gjatë 23 vjetëve të jetës profetike përmes edukimit shembullor, ndërtoi një individ dhe shoqëri të re. Nxori sahabët nga injoranca dhe fanatizmi arab, duke i kthyer si yje në qiell për të orientuar njerëzit drejt destinacionit të duhur. Ai ndërtoi qytetërimin e virtyteve, dashurisë dhe sakrificës, duke lënë pas një shoqëri e cila mburrej me krimet që kryente.

Ai kur u largua nga kjo botë la pas personalitete të jashtëzakonshme, të cilët mbartën me përgjegjësi të plotë amanetin e shenjtë dhe flamurin e Tevhidit. Katër kalifët e drejtë, dhjetë të përgëzuarit me Xhenet dhe të gjithë sahabët e tjerë si pasqyra reflektuan tek brezat pasardhës amanetin e shpalljes në katër anët e botës. Përmes tyre gjithë bota u njoh me dritën islame.

Kjo detyrë sublime do të transmetohet deri në Ditën e Kiametit nga dijetarët dhe njerëzit e zemrës. Trashëgimitë e vetme që na lanë pejgamberët janë dituria dhe urtësia.

TRASHËGIMTARËT E AMANETIT TË SHENJTË

Dijetarët janë trashëgimtarë të profetëve. (Ebu Davud, Ilim, 1)

Trashëgimtarët e Pejgamberit (a.s.), janë njerëzit e zemrës, të sinqertët, të diturit dhe të urtit. Ata janë trashëgimtarët e profetëve të shpërndarë në kohë.

Trashëgimtarët e Pejgamberit (a.s.), janë njerëzit e zemrës, të sinqertët, të diturit dhe të urtit. Ata janë trashëgimtarët e profetëve të shpërndarë në kohë.





Katër imamët e shkollave juridike, koleksionistët e traditës profetike, komentuesit e Kuranit dhe të gjithë dijetarët e sinqertë dhe të devotshëm të botës islame janë vazhduesit e edukimit dhe arsimimit të Profetit (a.s.).

Prijësit dhe juristët e drejtë transmetuan brez pas brezi amanetin e drejtësisë së Profetit (a.s.).

Edukimin shpirtëror e përmbushën në mënyrë të përsosur dijetarët e zemrave.

Të gjithë janë pishtarë udhëzimi. Ata që të gjithë ruajtën vijimësinë e qytetërimit islam. Ata ishin pasojë e lutjes:

وَاجْعَلْنَا لِلْمُتَّقِينَ إِمَامًا

“Na bëj shembull për të devotshmit.” (Furkan, 74)

Allahu në fillim të çdo shekulli dërgon një person për të ripërtërirë fenë. (Ebu Davut, Melahim, 1)

Sot shoqëria jonë ka nevojë për njerëzit e dashur të Allahut. Ka nevojë për udhëzimin e trashëgimtarëve të Profetit (a.s.), dijetarëve dhe të urtëve. Besimi i devijuar për shkak të paditurisë, ka nevojë për argumente.

Dijetarët e umetit tim janë si pejgamberët e Beni Israilëve. (Axhluni, II, 64/1744)

Sot shoqëria jonë ka nevojë për njerëzit e dashur të Allahut. Ka nevojë për udhëzimin e trashëgimtarëve të Profetit (a.s.), dijetarëve dhe të urtëve. Besimi i devijuar për shkak të paditurisë, ka nevojë për argumente.





Siç shkruhet edhe në hadithet e lartpërmendura, ruajtja me kujdes dhe transmetimi brez pas brezi i amanetit është bërë e mundur përmes këtyre njerëzve.

Historia është dëshmitare e kësaj të vërtete.

SHEMBUJ NGA HISTORIA

Pas periudhës së katër kalifëve të drejtë dhe fillimit të trazirave, kalifati ra në duar të njerëzve të dhënë pas kënaqësive të kësaj bote.

Siç thuhet edhe në fjalën e urtë: “Njerëzit janë në fenë e udhëheqësve”. Ata në stilin e tyre të jetesës filluan të ndjekin politikën shtetërore.

Kalifi Umejad Velid ibn Abdulmelik ishte i dhënë pas ndërtimeve të mëdha. Populli në periudhën e tij u orientua drejt ndërtimeve madhështore. Tema kryesore e bisedave dhe diskutimeve ishte ndërtimi.

Ashtu si të uriturit kanë nevojë për ushqim edhe shpirti ka nevojë për mjedis ku gatuhet ushqimi shpirtëror.

Sulejman ibn Maliku ishte një prijës i dhënë pas kulinarisë, për pasojë i gjithë populli në kohën e tij ishte i dhënë pas artit të gatimit.

“Nëse pasioni dhe zhytja jonë në dashurinë hyjnore do të ishte diçka konkrete, mbretërit do të sakrifikonin të gjithë mbretërinë dhe thesaret e tyre për ta marrë atë.”





Pastaj erdhi një prijës i devotshëm dhe i drejtë si Omer ibn Abdulaziz. Në periudhën e tij njerëzit filluan të garojnë me njëri-tjetrin në mirësi, në adhurim dhe bamirësi.

Kurse tema e diskutimeve ishte: “Sa ajete ke mësuar përmendsh sot? Sa ditë agjëron në javë? Sa bamirësi ke bërë sot?”

Në këtë mënyrë zemrat inkurajonin njëra-tjetrën në punë të mira.

Periudha e Omer ibn Abdulazizit zgjati vetëm dy vjet e gjysmë, por gjatë kësaj periudhe të shkurtër bota islame arriti një mirëqenie dhe qetësi të jashtëzakonshme. Guvernatorët nuk gjenin dot njerëz të varfër për t’u dhënë zekatin. Ngaqë të gjithë jepnin zekatin nuk kishte mbetur asnjë i varfër.

Në periudhën e këtij prijësi të drejtë dhe të devotshëm ishte krijuar një atmosferë e tillë shpirtërore të cilën Muhamed Ibn Ujejne e përshkruan kështu:

“Në kohën e Omer ibn Abdulazizit dërgova bagëtitë në Kirman. Për shkak të drejtësisë së zbatuar prej tij, ishte krijuar një atmosferë e tillë, saqë delet dhe ujqërit jetonin në paqe me njëri-tjetrin. Një natë ujqërit sulmuan kopenë e deleve. U habita dhe më ngjau sikur e gjithë bota kishte humbur qetësinë dhe sigurinë e deriatëhershme.

*Ashtu si të uriturit kanë nevojë
për ushqim edhe shpirti ka nevojë për mjedis
ku gatuhet ushqimi shpirtëror.*





Ashtu si i sëmuri ka nevojë për doktorin, edhe i sëmuri shpirtëror ka nevojë për doktorin e zemrës.

Thashë me vete se duhet të ketë vdekur kalifi i drejtë. Kur u interesova, mësova që kishte vdekur ata natë.”

Në kohën e Omer ibn Abdulazizit kufijtë e botës islame arritën deri në malet Pirene.

Por qëllimi kryesor i Islamit nuk është zaptimi i hapësirave dhe kalave, por çlirimi i zemrave. Këtë detyrë e kryenin dijetarët dhe njerëzit e zemrave.

Asketi i famshëm Bejazit Bistami, i cili ka jetuar në shekullin e katërt hixhri, një ditë kur po shkonte në xhami, i rrëshqiti këmba në rrugën me baltë dhe për të mos u rrëzuar u mbajti tek një mur. Muri u bë pis me baltë.

Me vete mendoi: “Akoma ka kohë deri sa të thirret ezani, po shkoj tek i zoti i murit dhe t’i kërkoj ndjesë.” I zoti i murit ishte ndjekës i Zarathustrës. Bejazit Bistami, pasi i tregoi për ndodhinë, i kërkoi ndjesë.

Ndjekësi i Zarathustrës gjithë habi pyeti:

Me të vërtetë feja ju mëson të jeni kaq të kujdesshëm dhe të sjellshëm? – Po- iu përgjigj Bistami.

Atëherë ndjekësi i Zarathustrës tha:

Imam Gazaliu, i cili ishte erudit në të gjitha shkencat e kohës, me ndihmën e Allahut arriti një gradë të lartë shpirtërore. Kjo bëri që ai të njihej në botën islame si Argumenti Islam.





“Edhe unë besoj në Zotin dhe Profetin tuaj.”

Kjo sjellje e mirë e Bistamit u bë shkak që të bëhej mysliman i gjithë fisi.

Ndërsa Islami përqafohej nga masa të madha njerëzish, në shekullin V Hixhri, pikërisht në periudhën që jetoi dijetari i madh Imam Gazaliu. Islami u përball me dy rreziqe të mëdha.

Nga njëra anë propaganda e sekteve të devijuara të cilat synonin shkatërrimin e Islamit, nga ana tjetër rryma të ndryshme filozofike rrezikonin besimin e pastër islam.

ARGUMENTI ISLAM

Imam Gazaliu, i cili ishte erudit në të gjitha shkencat e kohës, me ndihmën e Allahut arriti një gradë të lartë shpirtërore. Kjo bëri që ai të njihej në botën islame si Argumenti Islam. Ai luftoi ashpër kundër filozofisë dhe sekteve të devijuara. Në këtë mënyrë i bëri një shërbim të madh fesë islame, duke e ruajtur nga ndikimet negative.

Mësuesi dhe udhëzuesi i Imam Gazaliut ishte Pejgamberi (a.s.). Imam Gazaliu në lidhje me këtë thotë:

“Pashë që përveç strehimit tek bota shpirtërore

Imam Gazaliu thotë:

“Pashë që përveç strehimit tek bota shpirtërore e Pejgamberit, çdo gjë tjetër ishte bosh dhe iluzion. Arsyeja nuk është gjë tjetër veç se kufi”.





e Pejgamberit, çdo gjë tjetër ishte bosh dhe iluzion. Arsyeja nuk është gjë tjetër veç se kufi”

Në shekullin VIII hixhri, kur bota islame vuante dhe vajtonte nga pushtimet mongole dhe shteti i selxhukëve gjendej në vështirësi të madhe, Mevlana u bë burim ngushëllimi dhe frymëzimi për gjithë botën islame. Veprat e Mevlanës u bënë ngushëllim për zemrat e njerëzve, madje edhe sot e kësaj ditë vazhdojnë të tërheqin vëmendjen e shumë njerëzve.

Veprat e tij plot urtësi, të mbrujtura më dashurinë hyjnore ndihmuan në kapërcimin e krizës që kishte kapluar botën islame dhe u bënë frymëzim për krijimin e shtetit të fuqishëm Osman.

Në librin e Historisë Osmane, rrëfëhet një tregim interesant në lidhje me themelimin e shtetit Osman.

QOFTË I BEKUAR!

Sulltani i fundit i selxhukëve, Alaedini II kishte emëruar në një post të rëndësishëm një njeri të paafët. Në ceremoninë që organizoi për emërimin e tij, ishte i ftuar edhe Mevlana Xhelaledin Rumi. Rumi u mërzhitur nga ky emërim, në shenjë mosmiratimi u largua nga saraji mbretëror. Ndërsa po zbriste shkallët, u takua me Osman Gazin, i cili më vonë do të bëhej

Në shekullin 8-të hixhri, kur bota islame vuante dhe vajtonte nga pushtimet mongole dhe shteti i selxhukëve gjendej në vështirësi të madhe, Mevlana u bë burim ngushëllimi dhe frymëzimi për gjithë botën islame.





themeluesi i perandorisë Osmane. Rumi u ftoi për vizitë dhe e urdhëroi të lexonte Fatihanë, kurse vetë u zhyt në meditim.

Në mënyrë të papritur e pyeti Osman Gazin se sa herë e lexoi Fatihanë.

18 herë u përgjigj Osman Gazi

“Kaq nuk mjafton”, - ia ktheu Mevlana.

Pasi e lexoi edhe vetë Fatihanë 18 herë i dha këtë sihariq:

“Qoftë i bekuar sundimi yt dhe i pasardhësve të tu. Prej pasardhësve të tu do të rrjedhin plot 36 prijës.

Perandoria Osmane u themelua nga 400 kalorës. Nga një principatë e vogël dhe periferike arriti të sundonte një sipërfaqe prej 24 milion km². Arsyeja kryesore e këtij suksesi dhe e kësaj begatie ishte pikërisht bota shpirtërore e njerëzve të urtë.

Gejikliu, Emir Sultan, Akshemseddin, Jahja, Symbyl Efendi, Merkez Efendi, Yftade, Aziz Mahmud Hydai, Shemseddin Sivasi, Halid Bagdadi e shumë e shumë të tjerë përmes mësimave dhe këshillave të urta, bënë të mundur rilindjen e qytetërimit islam përmes Dinastisë Osmane.

Ne sot e kësaj dite përfitojmë nga ky qytetërim që krijuan ata mbi baza shpirtërore.

Veprat e Mevlanës plot urtësi, të mbujtura me dashurinë hyjnore ndihmuan në kapërcimin e krizës që kishte kapluar botën islame dhe u bënë frymëzim për krijimin e shtetit të fuqishëm Osman.





QYTETËRIMI MADHËSHTOR I INSTITUCIONEVE TË BAMIRËSISË

Institucionet e bamirësisë të ndërtuara mbi bazën e mëshirës dhe sinqeritetit si: xhami, spitale, shkolla, çezme, kuzhina dhe shumë institucione të tjera vazhdojnë shërbimin e tyre sot e kësaj dite.

Mirësitë e shpërndara nga Stambolli në 3 kontinente. Në secilën çezmë që ekziston dhe që pimë ujë patjetër që është ose dora e një sulltani ose e bashkëshortes së tij. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për xhamitë, spitalet dhe shumë institucione të tjera në shërbim të publikut.

Madje edhe silueta që kanë lënë në horizont shërbimet e të parëve tanë, pasqyron mirësi në zemrat tona dhe na ngjall ndjenja të bukura.

Në periudhën osmane ka pasur më shumë se 26 mijë vakëfe të themeluara e të regjistruara. Në sajë të këtyre vakëfeve arrinin në duart e të varfërve me dhjetëra shërbime, të cilat sot jepen vetëm kundrejt një pagese. Në atë periudhë, shoqëria ishte thurur si një rrjetë mëshire dhe dhembshurie. Njerëzit jetonin të qetë në ndërgjegjet e tyre. Midis të pasurit dhe të varfrit, të sëmurit dhe të shëndetshmit ishte krijuar një lidhje përgjegjësie e veçantë. Në pragjet e shtëpive ku gjendej një i sëmurë, vendosej një lule e kuqe, me

*Njerëzit e dashur të Allahut
nuk mjaftohen vetëm me përmisimin e vetes
por kërkojnë përmisimin e njerzëve të tjerë.*





qëllim që shitësit ambulantë ta shihnin dhe të mos thërrisnin me zë të lartë, ndërsa fëmijët të luanin në ndonjë lagje tjetër. Këto janë shembuj mëshire dhe karakteri, të cilat ndriçojnë edhe sot e kësaj dite.

Në vakëfet ku shfaqeshin këta shembuj, nuk u shërbehej vetëm myslimanëve, por edhe jomuslimanëve. Edhe atyre u tregohej butësia e Islamit. Për rrjedhojë, shumë prej tyre përqaftuan Islamin.

Zemrat e besimtarëve të devotshëm të cilët thellohen në vuajtjet e nevojtarëve dhe të dobëtëve, ziejnë si sheshi i mahsherit. Kjo djegie zemre, është e mbushur me dashurinë e shërbimit ndaj krijesave për hir të Krijuesit. Zemrat e tyre bëhen fole mëshire.

Krahët e mëshirës nuk iu hapën vetëm njerëzve, por edhe të gjitha krijesave që ishin nevojtare.

Në atë periudhë madhështore, sulltaneshat nuk ranë pre e qejfeve dhe e tundimeve të kësaj bote, si mbretëreshat dhe princeshat e zhytura në luks dhe shpërdorime.

Bashkëshortja e Harun Rashidit, zonja Zubejde dhe bashkëshortja bamirëse e Sulltan Sulejman Kanunit, sulltanësja Mihrimah, me pasurinë e tyre, ndanë dëshirën për ta çuar ujin e pijshëm të Damaskut në Arafat, në ato kushte të vështira të kohës. Ato treguan dashurinë e tyre për Haramejnin dhe mëshirën për myslimanët.

Zemrat e besimtarëve të devotshme të cilët thellohen në vuajtjet e nevojtarëve dhe të dobëtëve, ziejnë si sheshi i mahsherit . Kjo djegie zemre, është e mbushur me dashurinë e shërbimit ndaj krijesave për hir të Krijuesit. Zemrat e tyre bëhen fole mëshire.





Ndërsa sulltanësja Hatixhe Turhan, ka lënë si vakëf, shërbimin me sherbetin e mjaltit më të mirë të kohës për ditët e mira, që rridhte nga çezmat e Xhamisë së Re dhe i cili u shërbehej myslimanëve i përgatitur me dëborë të sjellë prej malit Uludag.

Madje, edhe sulltanësja Kosem, e cila në dukje ishte e ashpër, ka themeluar një vakëf që merrej me përgatitjen e pajës së shërbyeseve. Vetëm vakëfet e themeluar prej grave, ishin me mijëra.

TË MOS CENOHEN ZEMRAT!

Sulltanësja Bezmi Alem, e cila ka lënë vakëfe të mëdha si: Spitali i Guraba-i Muslim, Valide Xhami pranë Sarajit Dollmabahçe dhe ura e famshme e Gallatës, ka themeluar një vakëf edhe në Damask. Kushtet e këtij vakëfi, janë shumë të mahnitshme. Një prej tyre është edhe ky:

“Të dëmshpërblehen gotat që thyhen apo sendet që dëmtohen (pa dashje) nga shërbyesit që punonin pranë pronarëve të ashpër e të paedukatë, me qëllim që pronarët të mos i qortonin duke ua thyer zemrat.”

Karafi, një nga personalitetet e njohur të metodologjisë së jurisprudencës islame, ka thënë: “Edhe sikur Profeti i Allahut (a.s.), të mos kishte as-

Karafi, një nga personalitetet e njohur të metodologjisë së Jurisprudencës Islame, ka thënë: “Edhe sikur Profeti i Allahut (a.s.), të mos kishte asnjë mrekulli, sahabët që edukoi (me të cilët themeloi qytetërimin e virtyteve), do t’i mjaftonin si dëshmi se është një Profet i madh.





një mrekulli, sahabët që edukoi (me të cilët themeloi qytetërimin e virtyteve), do t'i mjaftonin si dëshmi se është një Profet i madh”.

Ndërsa në vakëfin e Sulltan Mehmet Fatihut, ishte menduar një shërbim për myslimanët, me qëllim që të ruheshin nga pamjet e këqija e të shëmtuara në rrugë:

“Me të ardhurat e fituara prej pronave të mia të patundshme, të vendosen nga dy persona në çdo rrugicë të Stambollit. Këta do të lëvizin nëpër rrugica në orë të caktuara të ditës me një enë të mbushur me pluhur gëlqereje dhe hi qymyri, me qëllim që të mbulojnë pështymat nëpër rrugica. Pagesa ditore e tyre, të jetë nga 20 akçe.”

Gjithashtu, Sulltani Mehmet Fatih, ka vendosur edhe një shërbim, ku synohej të ruheshin dinjiteti dhe ndjenjat e të varfërve dhe t'u shërbehej atyre me ëmbëlsi:

“Familjeve të dëshmorëve të çlirimit të Stambollit dhe jetimëve, t'u shërbehet me enë të mbyllura, pasi të bjerë muzgu, për të mos tërhequr vëmendjen e fqinjëve, me qëllim që të ruhet dinjiteti dhe respekti ndaj tyre!..”

Sa qytetërim njerëzor i madhërishtëm është Islami, i cili i edukoi edhe shpirtrat më të pagdhendur, duke i kthyer ata në zemra dhe shpirtra të butë, që shohin, dëgjojnë dhe ndjejnë.

Sa qytetërim njerëzor i madhërishtëm është Islami, i cili i edukoi edhe shpirtrat më të pagdhendur, duke i kthyer ata në zemra dhe shpirtra të butë, që shohin, dëgjojnë dhe ndjejnë.





Në qytetërimin tonë, ai që jepte, ia dinte për nder atij që merrte. Në sajë të “gurëve të sadakasë” nëpër xhamia, ai që merrte nuk e njihte atë që jepte. Në këtë mënyrë, edhe ai që jepte ruhej nga ndjenja e hipokrizisë. Gjatë muajit të Ramazanit, bamirësit shkonin nëpër dyqane dhe kërkonin defterët e borxheve, me qëllim që të lanin borxhet e të varfërve, pa e bërë të ditur se kush janë.

Me vetëdijen se: **“Lëmoshat i merr Allahu!”** (Teube, 104) dhënësi tregohet i edukuar dhe i thjeshtë, sikur po ia jepte Allahut. Sa bukur e shpreh ky shembull ëmbëlsinë e dhurimit:

Sulltani Mustafai III, në muajin e Ramazanit shkoi një natë për iftar në konakun e Shejhu'l Islamit, Mehmet Emin Efendisë. Gjatë bisedës tha:

“Mehmed Emin Efendi, kisha dëshirë të vija herë pas here tek ju, por konaku juaj është goxha larg!”

Ndërsa Mehmed Emin Efendiu, me mirësjellje dhe modesti, bëri një shpjegim tërthorazi:

“Sulltan im! Në sajën tënd, është e mundur të siguroj një shtëpi më afër, mirëpo, siç e shihni, në asnjërin prej shtëpive përqark nuk ka vend gatimi.”

Për shkak të këtij shpjegimi të tërthortë, sulltani u habit dhe pyeti:

Sa qytetërim i madhërishtëm dhe i kulturuar është Islami, i cili edukoi personalitete të përsosura që e shfaqën shpirtin e tyre njerëzor me mëshirë dhe thjeshtësi të jashtëzakonshme!





“E çuditshme! A nuk gatujnë gjellë në këto shtëpi?”

Pas kësaj Mehmed Emin Efendiu i jep një përgjigje që pasqyron botën e tij të brendshme:

“Ushqimi i mëngjesit dhe i darkës shpërndahet nga kjo kuzhinë e thjeshtë, prandaj nuk dëshiroj të largohem prej këtu.”

Sa qytetërim i madhërishëm dhe i kulturuar është Islami, i cili edukoi personalitete të përsosura që e shfaqën shpirtin e tyre njerëzor me mëshirë dhe thjeshtësi të jashtëzakonshme!

MËSHIRË GJITHËPËRFSHIRËSE NDAJ KRIJESAVE

Afërsisht një shekull pas Mevlanës, Shah Nakshibendi, mësuesi i madh i rrugës Haxhegan, filloi në Horasan çlirimin e zemrave me metodën e edukimit shpirtëror me bazë bisedën dhe shërbimin. Me mëshirën e tij gjithëpërfshirëse ndaj të gjitha krijesave në vijën e devotshmërisë dhe rrugës së drejtë, ai është bërë shembulli praktik i ndjekësve të tij prej shumë shekujsh. Kjo rrugë e bekuar, është bërë shkak që e gjithë bota prej Maveraunnehirit e deri në Indi, në Irak, në Anadoll dhe në Ballkan, të shohin bukuritë e fshehta dhe të dukshme të Islamit.

Jetët e miqve të Allahut, vazhdojnë t'u shërbejnë zemrave besimtare që presin udhëzim, edhe pas jetëve të tyre të përkohshme. Kjo, arrihet në sajë të nxënësve që kanë edukuar dhe veprave që kanë lënë pas.





I nderuari Ubejdullah Ahrari, një prej të dashurve të Allahut, i cili vjen prej zinxhirit të tij të ndritshëm, ka marrë pjesë edhe në çlirimin e Stambollit. Ai kishte vakëfe, medrese, mensa ushqimi dhe spitale që u kanë shërbyer mijëra njerëzve përreth zonës së Semerkandit. Shumë vende pranuan Islamin në sajë të këtyre përpjekjeve fizike dhe kësaj ndihme shpirtërore.

Ndërkohë që po përfundonte mijëvjeçari i parë i hixhrit, në zonën e Indisë filluan ngatërresat. Një sundues me emrin Ekber Shah, bashkoi Islamin me Hinduizmin dhe u përpoq të nxirrte një fe të rreme, të cilën e konsideronte si fe hyjnore, duke nxjerrë edhe ligje në kundërshtim me parimet islame.

EDUKIMI SHPIRTËROR

Imam Rabbani, në sajë të përpjekjeve të tij këmbëngulëse, duke pastruar zemrat arriti ta eliminonte këtë problem nga zonat e Indisë. Për këtë arsye, edhe Alemgiri, nipi i Ekber Shahut, u bë ndjekësi i rrugës së Imam Rabbanit.

Ndikimi i Imam Rabbanit, nuk mbeti vetëm në Indi. Ky mik i Allahut, i cili u bë edhe ripërtëritësi i mijëvjeçarit të dytë, e ngriti mistikën mbi themelet e Kuranit dhe Sunetit, duke u lënë ndjekësve të ardhshëm të kësaj rruge shpirtërore, një rrugë të drejtë.

Profeti (a.s) këshilloi Ibn Omerin (r.a):

"O Ibni Omer, kapu fort pas fesë, kapu fort pas fesë!

Sepse ajo është mishi dhe gjaku yt. Ki kujdes

prej kujt e mëson fenë!"





Gjithashtu, edhe në qendra të tjera Islame, ku është punuar shumë për të shuar dritën e Islamit, kanë vepruar shumë të dashur të Allahut, të cilët i kanë eliminuar problemet duke e edukuar popullin me pastrimin shpirtëror.

Shoqëritë gjithmonë kanë gjetur paqe në sajë të miqve të Allahut. Teqetë e tyre kanë qenë gjithmonë qendra rehabilitimi për shpirtrat e lodhur, të hidhëruar, të vetmuar dhe të plagosur. Po ashtu, edhe çerdhet familjare që përjetonin probleme, kanë mundur të qëndrojnë në këmbë, në sajë të këshillave të tyre për durim dhe mëshirë. Kjo, sepse ato teqe ishin vazhdimi i Daru'l-Erkamit dhe i As'hab-i Suffas. Ato ishin përpjekja për vazhdimin deri në Kiamet të pastrimit shpirtëror të Rasulullahut (a.s.). Dhe energjia e këtyre përpjekjeve, ishte dashuria për Allahun.

DASHURIA HYJNORE

Çfarë është ajo që i bën kaq shumë njerëz, që prej sulltanëve e deri tek populli i thjeshtë, të vijnë rrotull këtyre miqve të Allahut si flutura?

Interesi, posti apo autoriteti?!

Absolutisht jo!

Përkundrazi, ata që vraponin drejt tyre, kishin

Profeti (a.s) thotë:

“Ki kujdes prej kujt e mëson fenë, diturinë dhe dispozitat fetare mësoi prej njerzëve të ditur dhe të drejtë, mos i merr prej atyre që kanë humbur drejtimin.”





dhuruar gjithçka që kishin. Nëse u është dashur, e kanë braktisur edhe postin dhe e kishin vënë nën këmbë autoritetin e përkohshëm që kishin. Për shembull, Aziz Muhamud Hudaji, i cili ishte gjykatës i Bursës, e kishte braktisur vendin që kishte në administratën shtetërore. Me përvujtni ai filloi të shiste mëlçi në rrugicat e Bursës. Ai ka qëndruar me muaj të tërë nën edukimin e dijetarit dhe mësuesit të famshëm Halid-i Bagdadit dhe Abdullah Dehleviut, duke përgatitur ujin e abdestit dhe duke pastruar tualetet.

Pra, ajo që i tërhiqte ata drejt miqve të Allahut, ishte një dashuri e falur prej Allahut të Madhëruar. Në ajetin 96 të sures Merjem, urdhërohet:

إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ
سَيَجْعَلُ لَهُمُ الرَّحْمَنُ وُدًّا

“Në të vërtetë, atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i Gjithëmëshirshmi do t’u dhurojë dashuri.”

(Merjem, 96)

Nëse Allahu e do një rob të Tij, e bën atë të dashur edhe për banorët e tokës dhe të qiellit. Dhe ata njerëz të mirë, bëhen udhërrëfyes të besimtarëve që i ndjekin. Kjo dashuri që Zoti ka bërë të mundur, është aq ndikuese, saqë shërbimet e atyre njerëzve të lartë, vazhdojnë edhe pas jetës së tyre të përkohshme.

Shoqëritë kanë gjetur qetësi vetëm në sajë të njerëzve të dashur të Allahut. Vendet e tyre kanë qenë shndërruar në qendra rehabilitimi për të varfrit, jetimët dhe të vetëmuarit.





I nderuari Mevlana ka thënë:

“Pas vdekjes sonë, mos e kërkonit varrin tonë në tokë. Varri ynë është në zemrën e të diturve.”

Jetët e miqve të Allahut, vazhdojnë t’u shërbejnë zemrave besimtare që presin udhëzim edhe pas jetës së tyre të përkohshme. Kjo, arrihet në sajë të nxënësve që kanë edukuar dhe veprave që kanë lënë pas.

Gjatë jetës së tyre ata kanë formuar një umet me njerëzit që kanë takuar, ndërsa pas vdekjes, e kanë vazhduar udhëzimin e tyre ndaj umetit me anë të veprave, shkollave dhe njerëzve që kanë edukuar. Nisur nga kjo shoqëria e kohëve tona ka nevojë për një udhëzim të tillë. Kanë nevojë për udhëzimin e trashëgimtarëve të Profetit (a.s.) dhe njerëzve të devotshëm.

Gjithashtu, të rinjtë me potencial, por pa qëllim, kanë nevojë për mendje të pjekura që do t’u tregojnë horizontet e duhura.

Prirjet e egra të adoleshentëve kanë nevojë për edukimin me butësi, durim, pjekuri dhe mëshirë.

Egot e kapluara prej mendjemadhësisë, kanë nevojë për mësues që do t’u mësojnë thjeshtësinë, duke u treguar shërbimin.

Njerëzit e dijes që mburren me diturinë e tyre të

Çerdhet familjare që përjetonin probleme, kanë mundur të qëndrojnë në këmbë, në sajë të këshillave për durim dhe mëshirë. Kjo, sepse ato ishin vazhdimi i Daru’l-Erkamit dhe i As’hab-i Suffas.





thatë, kanë nevojë për gjetjen e rrugës së drejtë, që do t'i ruajë ata nga shkarjet.

Ashtu siç kanë nevojë të uriturit për mensat, ashtu kanë nevojë edhe të uriturit shpirtërorë për edukim.

Ashtu siç kanë nevojë të sëmurët për mjekët, ashtu ka nevojë edhe njerëzimi që po përpëlitet në probleme shpirtërore, për mjekët e zemrave.

Aliu (r.a.), ka thënë:

“Qëndroni me njerëzit e sinqertë dhe besnikë, me qëllim që t’ju kërkojnë njerëzit sa të jeni në jetë dhe të përmallohen për ju pasi të vdisni.”

NJERËZIT E EDUKUAR TË NJË QYTETËRIMI TREGOJNË VLERËN E TIJ

Çdo qytetërim, formon tipin e vet njerëzor. Është ai tip njerëzor që shfaq harmoni me veçoritë dhe karakterin e qytetërimit të cilit i përket.

Njerëzit e lartë me vargun e virtyteve dhe të edukatës (disa nga të cilët i përmendëm) janë shembujt më të zgjedhur të qytetërimit islam.

Ndërsa sot, për fat të keq, njerëzit tanë i edukon qytetërimi i egër perëndimor. Shoqërinë tonë e

Në sajë të “gurëve të sadakasë” nëpër xhamia, ai që merrte nuk e njihte atë që jepte.

Në këtë mënyrë, edhe ai që jepte ruhej nga ndjenja e hipokrizisë.





edukojnë kanalet e pista, botimet e degjeneruara, reklamat e padobishme, moda në formën më egoiste, më të paedukatë dhe më injorante.

Edhe silueta që kanë lënë në horizont shërbimet e të parëve tanë, reflekton mirësi në zemra, ngjall ndjenja të bukura dhe tregon madhështinë e këtij qytetërimi.

Ky është një qytetërim që përfshin të gjitha anët e jetës.

Qytetërimi islam është qytetërim në humanizëm, në moral dhe në personalitet.

Periudha e kalifëve të drejtë, periudha e Omer ibn Abdulazit dhe tre shekujt e parë të Perandorisë Osmane janë shembuj tipikë të madhështisë së qytetërimit dhe kulturës islame.

Ai është një qytetërim monumental me institucionet të ndërtuara drejt dhe njerëz të edukuar. Të gjithë personalitetet që përmendëm janë produkt i këtij qytetërimi.

Fatkeqësisht, sot njerëzit tanë edukohen vetëm sipas mënyrës së qytetërimit perendimor.

Shoqëria jonë orientohet nga mendja e shturur, reklama të rreme dhe nga moda. Kjo sjell mbizotërimin e egoizmit, indiferentizmit dhe tjetërsimin e individit.

"Familjeve të dëshmorëve të çlirimit të Stambollit dhe jetimëve, t'u shërbehet me enë të mbyllura, pasi të bjerë muzgu, për të mos tërhequr vëmendjen e fqinjëve, me qëllim që të ruhet dinjiteti dhe respekti ndaj tyre!.."





Detyra jonë përballë kësaj ere të ashpër, është:

Të jetojmë duke u kapur fort pas amanetit të Profetit tonë (a.s.). Të jetojmë me të dukshmen dhe me të fshehtën e Kuranit e të Sunetit, duke u përpjekur që me anë të urdhërimit për të mirë e ndalimit nga e keqja, të bëhemi përsëri umeti më i mirë. Duhet t'ua lëmë këtë synim si trashëgim edhe brezave të ardhshëm.

O Allah!

Mos na ndaj ne, brezat dhe shoqërinë tonë prej rrugës së ndritur dhe të bekuar të Profetit tonë (a.s.), mos na privo prej dijes dhe kulturës që është trashëgimia e vërtetë e Profetit (a.s.). Mos na ndaj prej dijetarëve të sinqertë dhe të devotshëm që janë trashëgimtarët e tij!

Amin!..



*“Në të vërtetë, atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira,
i Gjithëmëshirshmi do t’u dhurojë dashuri.”*

(Merjem, 96)



وَمَا كَانُوا يَذْرَؤْنَكَ وَلَكِنَّ اللَّهَ مُبْتَلِيهِمْ
وَمَا كَانُوا يَذْرَؤْنَكَ وَلَكِنَّ اللَّهَ مُبْتَلِيهِمْ

HORIZONTI
I NDËRGJEGJES
dhe KUFIRI
I NJERËZISË
SONË



*“Ka dy sy, që nuk i prek zjarri i Xhehenemit:
Syri që qan për hir të Allahut dhe syri që gdhahet
zgjuar duke bërë roje në rrugë të Allahut.”*

(Tirmidhi, Fedailu'l-Xhihad, 12/1639)



HORIZONTI I NDËRGJEGJES DHE KUFIRI I NJERËZISË SONË

KA DY SY QË...

Profeti ynë i dashur (a.s.), thotë:

“Ka dy sy, që nuk i prek zjarri i Xhehenemit:

- *Syri që qan për hir të Allahut,*
- *Syri që gdhihet zgjuar duke bërë roje në rrugë të Allahut.”* (Tirmidhi, Fedailu'l-Xhihad, 12/1639.)

Cilësitë e këtyre dy syve të çliruar prej Xhehenemit janë:



Frika nga Allahu, dhembshuria, shërbimi dhe përpjekja.

Një sy që kur zotëron vetëdijen e të qenit nën vëzhgimin e kamerave hyjnore, e madhëron Allahun sikur është duke e parë, dridhet përballë madhështisë dhe fuqisë së Tij, ndjen frikë, digjet nga dashuria dhe loton prej peshës që i jep detyra e përgjegjësia.

Ai është një besimtar që e ndjen në supe gjynahun e amanetit që bart, që i ndjen në ndërgjegje vuajtjet materiale, e sidomos shpirtërore të njerëzve që duhet të mbrojë dhe që me këtë përpjekje, derdh djersë po aq sa derdh edhe lot.

Një besimtar, që për të mbrojtur fenë, atdheun, vëllain e fesë, vëllazërinë, unitetin; për të ruajtur nderin dhe namusin e vetes, familjes e kombin e tij nga sulmet, qëndron në kufi pa vënë gjumë në sy.

Ja pra, një rob i tillë, është një besimtar që ka gëzuar mëshirën hyjnore, aq sa mund të shuajë Xehenemin me dritën e tij.

Shembulli më i përsosur i kësaj, është Profeti ynë i dashur (a.s.), i cili zotëronte përsosmërinë e virtyteve të butësisë, dhembshurisë, mëshirës, përpjekjes, thjeshtësisë dhe frikës ndaj Allahut.

Namazi është shumë i rëndësishëm. Ai duhet të falet me frikë e respekt ndaj Zotit (xh.sh.), në mënyrë të vazhdueshme dhe të kujdesshme, në mënyrë që ai namaz ta mbajë larg dhe ta mbrojë falësin e tij nga cdo lloj ligësie dhe veprë të shëmtuar.





PROFETI I DREJTËSISË DHE MËSHIRËS...

Viti i dytë i hixhrit përkon me datën 14 mars 624 (sipas kalendarit Gregorian).

Profeti (a.s.), ndodhet në Bedër së bashku me 313 sahabët e tij. Përballë tyre qëndron ushtria e idhujtarëve kurejshë, që ishin tri herë më shumë në numër dhe të armatosur më mirë. Profeti (a.s.), e kalon natën nën një pemë, duke derdhur lot për Allahun dhe duke i drejtuar mëshirës hyjnore lutje që i buronin nga shpirti. Ai e gdhin mëngjesin me kijame dhe sexhde, për mbrojtjen fizike dhe shpirtërore të sahabëve të tij, që po flinin të qetë.

Ai Profet mëshire, i përgjerohej Allahut për fitore. Rrezet e ndritshme të kandilit të Islamit që kishin zënë vend në Medinë, duhej të përhapeshin kudo në horizont. Duhej eliminuar çdo pengesë që e rrezikonte Islamin, ndaj duhej lufta dhe çlirimi. Çlirimi i zemrave...

Myslmanët shkuan herët në fushën e betejës dhe u pozicionuan në vendin ku ndodheshin pusët e Bedrit. Për të përfituar prej ujit të puseve, kishin bërë një hauz.

Kur erdhi ushtria e kurejshëve, një pjesë prej idhujtarëve ndër të cilët ishte edhe Hakim bin Hizami,

"Prindërve të atij që e lexon Kurandin Fisnik dhe punon me të, Ditën e Gjykimimit do t'u vihet një kurorë Drita e kësaj kurore është më e bukur se drita që jep dielli kur bie në një shtëpi në këtë botë. Atëherë, pa mendoni se si mund të jetë drita e atij që punon vetë me Kurandin Fisnik?"

(Ebu Davud, Vitri, 14.)





u afruan të pinin ujë prej hauzit të myslimanëve. Kur myslimanët tentuan t'i pengonin, Profeti i Allahut (a.s.), tha:

“Lërini të pinë!”

Leja që të pinin ujë njerëzit me të cilët pas disa orësh do të plaste lufta shpatë për shpatë, është një shprehje madhështore e fisnikërisë dhe karakterit të lartë të Islamit.

NJERËZI EDHE NDAJ ARMIKUT

Kjo leje është parimi njerëzor dhe metoda më e bukur e udhëzimit që na mësohet ne. Bujaria, fisnikëria dhe njerëzia e shfaqur në kohë të vështira, do të zbuste zemrat e ngurtësuar dhe do të hidhte themelet e udhëzimit në ato zemra. Për rrjedhojë, Hakimi, i cili atë ditë piu ujë nga ai pus, më vonë u bë mysliman. Kur Hakimi dëshironte ta forconte fjalën e tij me një betim, thoshte:

“Jo! Beto hem në Allahun që më shpëtoi nga vdekja në Bedër dhe më dha mirësinë e besimit!” (Ibn Hisham, II, 261.)

Atë ditë, në Bedër u realizua fitorja më madhështore në botë. Shumë prej parisë së idhujtarëve më të flaktë Mekas, të cilët i tallën, i ofenduan, i akuzuan dhe

*“Uetëm dijetarët i frikësohen Allahut.” (Fatir,28)
Prandaj duhet të pajisemi me dituri që na rrit
frikërrespektin ndaj Allahut.*





i torturuan në mënyrat më çnjerëzore Profetin (a.s.) dhe myslimanët që prej 14 vitesh, shkuan në Xhehenem. Ndërsa shtatëdhjetë prej tyre, u kapën rob.

Po ashtu, edhe sjellja që u tregua ndaj robërve, tregoi më së miri butësinë dhe ëmbëlsinë e Islamit. Ebu Azizi, vëllai i Mus'ab bin Umejrit, i cili ishte ende prej idhujtarëve, ndodhej midis robërve të kapur në luftën e Bedrit. Si shpërblim për lirinë e tij, ai duhej t'u mësonte fëmijëve shkrim dhe këndim. Ai u caktua të qëndronte në shtëpinë e një familjeje të varfër të ensarëve. Familja ensare, ushqimet e vështira për t'u gjendur ia jepte robit të luftës, i cili u mësonte shkrim dhe këndim fëmijëve. Ndërsa për vete e shtynin me hurma dhe ujë. Ebu Azizi tregon:

“Unë turpërohesha kur shihja se ajo familje m'i jepte mua ushqimet më të mira që gjenin, ndërkohë që për vete hanin vetëm hurma me ujë. Megjithëse unë u thashë: «Mos bëni kështu! Edhe unë dua të ha hurma e të pi ujë si ju, ndërsa këto ushqime të shijshme jepuani fëmijëve!», - ata thoshin: «Jo! Ne kështu na ka urdhëruar Profeti i Allahut.»” (Hejthemi, VI, 86; Ibn-i Hisham, II, 288.)

Kjo njerëzi, mëshirë dhe përgjegjësi, pa kaluar shumë, nderoi me Islam Ebu Azizin dhe shumë tjerë si ai. Prej njerëzve të egër e të pagdhendur të periudhës së injorancës, doli në pah një qytetari virtytesh, e

“Ata që janë më afër meje prej njerëzve, janë të devotshmit kundrejt Allahut kushdo qofshin dhe kudo qofshin ata.” (Ahmed, V, 235; Hejsemi, IX, 22.)





cila ndërtoi personalitete të larta me zemër të butë, ndërgjegje të pastër dhe të përkushtuar ndaj Allahut.

Profeti ynë (a.s.), që qante për Allahun e derdhte lot për umetin, edhe për çlirimin e Mekës, tregoi po të njëjtën njerëzi dhe bujari. Madje, para se të çlirohej Meka, ai dërgoi ndihma për banorët e saj gjatë kohës së zisë për bukë. Në rrjedhën e ngjarjeve që shkojnë deri tek çlirimi i Mekës, ai i mori të gjitha masat e duhura, me qëllim që çlirimi të mos ishte “dita e derdhjes së gjakut, por dita e mëshirës”.

DITA E MËSHIRËS

Çlirimi u realizua dhe tashmë ishte krijuar mundësia për t’u hakmarrë ndaj njëzet vjetëve padrejtësi, tortura dhe vrasje. Ata që u bënë shkak i martirizimit të vajzës së Profetit (a.s.) dhe që përdhosën edhe trupin e xhaxhait të tij, qëndronin përballë komandantit të ushtrisë fitimtare islame, Rasulullahut (a.s.), duke pritur fermanin që do të dalë prej dy buzëve të tij.

Mirëpo, ai det mëshire dhe faljeje, i pyeti ata:

“O bashkësi e Kurejshëve! Çfarë mendoni se do të veprojnë me ju tani?”

Kurejshët, thanë:

Profeti (a.s.), zotëronte përsosmërinë e virtyeteve të butësisë, dhembshurisë, mëshirës, përpjekjes, thjeshtësisë dhe frikës ndaj Allahut.





“Ne shpresojmë se ti do të bësh mirë. Prandaj themi: «Do të bësh mirë, sepse ti je një vëlla bujar dhe bamirës. Ti je biri i një vëllai bujar dhe bamirës!”

Pas kësaj, Profeti (a.s.), tha:

“Edhe unë, do t’ju them ashtu siç u tha Jusufi vëllezërve të tij:

لَا تَثْرِبَ عَلَيْكُمُ الْيَوْمَ يَغْفِرُ اللَّهُ لَكُمْ
وَهُوَ أَرْحَمُ الرَّاحِمِينَ

“...Sot s’ka qortim për ju; Allahu do t’ju falë. Ai është më i mëshirshmi i mëshiruesve!” (Jusuf, 92) *Tani shkoni, jeni të lirë!”*

Profeti (a.s.), nuk cenoi askënd dhe as nuk u cenua. Në vend që t’i dëbonte banorët e Hajberit, të cilët deshën ta vrisnin, ai i la ata në tokat e tyre, si ortakë në administrim. Plaçkën e madhe të luftës që u fitua në betejën e Hunejnit, e ndau bujarisht për njerëzit që dëshironte t’u ngrohte zemrën ndaj Islamit. Kjo, sepse ai kërkonte të fitonte zemrat dhe jo të hakmerrej duke u marrë jetën apo pasurinë të tjerëve. Profeti (a.s.), kërkonte të fitonte zemra e të bëhej shërim dhe zgjidhje për çdo hall të umetit të tij. Dhe në këtë rrugë, ai ishte i gatshëm të vuante, të duronte fyerje, të derdhte djersë e lot dhe të kalonte net të tëra pa gjumë.

Profeti (a.s.), që qante për Allahun e derdhte lot për umetin, edhe për çlirimin e Mekës, tregoi po të njëjtën njerëzi dhe bujari.





Në zemrën e tij ziente mëshira dhe dhembshuria. Megjithëse me mundësi të dobëta e të mangëta, Ai u drejtua drejt qëllimit më të lartë dhe arriti rezultate të mrekullueshme. Ai arriti të edukojë mijëra sahabë të cilët morën hisen e tyre prej frymëzimit të tij shpirtëror. Ai edukoi një brez të devotshëm ndaj Allahut, sakrifikues ndaj të Dërguarit të Tij, shërbyes ndaj umetit dhe vetëmohues.

Ai brez, e barti si flamur fytyrën e buzëqeshur të Islamit prej Kinës deri në Oqeanin Atlantik, prej Etiopisë deri në Stamboll dhe i mësoi njerëzimit besimin që i jep vlerën e vërtetë, adhurimin, moralin dhe gjykimin e drejtë.

Kur Omeri (r.a.), mori lajmin se djali i një guvernatori (valiu), kishte rrahur një njeri, e thirri valiun menjëherë në Medinë dhe e qortoi duke i thënë:

“Qëkur keni filluar t’i skllavëroni njerëzit që kanë lindur të lirë prej nënave të tyre?”

Një hebre i Hajberit, kafshonte gishtat prej drejtësisë që shfaqti një sahab dhe nuk e mbajti dot veten pa thënë: “Pikërisht prej këtij rregulli qëndrojnë në këmbë toka dhe qiejt!”

Të gjitha këto, sepse sahabët vepronin në bazë të Kuranit dhe Sunetit të Profetit (a.s.). Ata e kishin zhdukur egoizmin, kishin zhvilluar aftësitë shpirtërore,

*Këta janë kufijtë e caktuar prej Allahut.
Atë që i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij,
Ai e shpie në kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj
dhe ku do të qëndrojë përherë.*

Kjo është fitorja e madhe. (Nisa, 13)





i shihnin njerëzit me syrin e dhembshurisë dhe mëshirës së Krijuesit, duke u bërë ambasadorë të mëshirës dhe udhëzimit.

Ata e kuptuan se njerëzimi dhe myslimanizmi, gjelbërojnë vetëm brenda kufijve që ka vendosur Allahu i Madhëruar. Ata e shkrinë mendjen brenda shpalljes hyjnore dhe zemrën brenda shpirtit të Librit të Allahut dhe Sunetit të Profetit (a.s.). Atyre u ndryshoi shikimi ndaj gjithësisë dhe materies. Ata mësuan ta peshojnë gjithçka sipas kënaqësisë së Allahut dhe të respektojnë kufijtë e Tij.

RESPEKTIMI I KUFIJVE TË ALLAHUT

Sepse ata e pranorin me zemër se:

وَمَنْ يَتَعَدَّ حُدُودَ اللَّهِ فَقَدْ ظَلَمَ نَفْسَهُ

“...Kush i kapërcen kufijtë e Allahut, pa dyshim që i ka bërë padrejtësi vetes.” (Talak, 1)

Ata kishin mësuar të arrinin paqen e bindjes ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij (a.s.), duke shpëtuar edhe veten, edhe botën prej padrejtësisë së vetes. Në një ajet fisnik, urdhërohet:

تِلْكَ حُدُودُ اللَّهِ وَمَنْ يُطِعِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ

“Ndërsa atë që nuk i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe shkel kufijtë e vënë prej Tij, Allahu e shpie në zjarr, ku do të qëndrojë përherë dhe për të ka ndëshkim poshtërues.” (Nisa, 14)





يُدْخِلُهُ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا
وَذَلِكَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ

“Këta janë kufijtë e caktuar prej Allahut. Atij që i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, Ai e shpie në kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe ku do të qëndrojë përherë. Kjo është fitorja e madhe.” (Nisa, 13)

وَمَنْ يَعِصِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَيَتَعَدَّ حُدُودَهُ يُدْخِلْهُ نَارًا
خَالِدًا فِيهَا وَلَهُ عَذَابٌ مُهِينٌ

“Ndërsa atë që nuk i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe shkel kufijtë e vënë prej Tij, Allahu e shpie në zjarr, ku do të qëndrojë përherë dhe për të ka ndëshkim poshtërues.” (Nisa, 14)

Çlirimin e zemrave me mëshirë dhe dhembshuri që realizoi Profeti (a.s.), e vazhduan edhe brezat e devotshëm e të sinqertë që pasuan.

Sulltani Alparslan, i veshur me rroba të bardha, që simbolizonin qefinin, me ushtrinë që komandonte vetë, arriti të mundë në Luginën e Malazgirtit ushtrinë e Bizantit, që ishte shumë herë më e madhe se ushtria e tij. Më pas, u soll në mënyrë të njerëzishme me Perandorin Diogjen, i cili ishte mundur dhe kishte rënë rob, duke e lënë atë të lirë.

Në qoftë se madhështia e qëllimit, ngushtësia e mjeteve dhe pafundësia e rezultateve të arritura, do të ishin tri kritere për të matur gjeninë njerëzore, atëherë kush do të guxonte të përqaste njerëzit më të mëdhenj të kohëve moderne me figurën e Muhammedit?





Po ashtu, e njëjtë ishte edhe sjellja e Jëlldërëm Bejazidit ndaj kalorësve francezë, të cilët kërkuan falje prej tij, duke u betuar: “Nuk do të vijmë më!”

Kështu ishte edhe sjellja e Sullan Mehmet Fatihut ndaj patriarkut të mundur të Bizantit.

Shpata zhdukte vetëm padrejtësinë, thyente dyert e burgjeve dhe i shërbente misionit të largimit të pengesave midis njerëzve drejt rrugës së vetme të lumturisë së përjetshme, Islamit.

Murati i Parë dha jetën e tij në fushën e Kosovës për fitoren e Islamit. Në atë vend të çliruar u sollën familje myslimane nga Anadoli, të cilat e kishin bërë Islamin pjesë të natyrës së tyre. Jeta e tyre shembullore, ndikoi pozitivisht tek popullsia vendase dhe për rrjedhojë, populli i Maqedonisë, Kosovës dhe Shqipërisë u nderuan me Islam.

Edhe në çlirimin e Bosnjës nga Sulltan Mehmet Fatihu, u realizuan të njëjtat qëllime dhe u arritën të njëjtat rezultate. Boshnjakët i admiruan myslimanët e butë, të dashur e të ndjeshëm, që shihnin përreth xhamive duke e pranuar Islamin grupe-grupe. Ja pra, në sajë të këtyre sakrificave, përpjekjeve, lotëve, djersës dhe vuajtjeve po zgjerohej edhe rrethi i umetit që pranonte Islamit duke iu afruar lumturisë së përjetshme.

Tre veçori kishte në çlirimet e Profetit (a.s.):

- 1. Qëllimi madhor dhe universal...*
- 2. Mundësitë të vogla ose po thuajse hiç...*
- 3. Megjithatë për sa i përket përfundimeve që arriti Ai është i pashoq...*





Shpatat e fatihëve, mbrojtën popujt e mjeruar prej heshtave të vojvodinasve dhe prej sundimtarëve tiranë e të pashpirt. Në shumë raste, ushtritë osmane që përhapnin drejtësi, çliruan shumë vende me ftesën e popujve të shtypur vendas. Madje, edhe pas shumë shekujsh, presidenti hungarez Pal Schmitt, e ka kujtuar me mirënjohje faktin se shkak i vetëm i mbijetesës së popullit të tij, ishte qëndrimi i tyre për 150 vite nën administrimin e Osmanëve.

Po ashtu, edhe këto përshtypje të gazetarëve dhe ambasadorëve të huaj që i përkasin periudhës së fundit osmane, tregojnë qartë se sa të gjalla ishin në këtë popull karakteri dhe fisnikëria islame deri në çastet e fundit.

VIRTYTET E DOHUARA PREJ ARMIKUT...

Mouradgea d'Ohsson, ka qenë ambasador i Suedisë në Stamboll. Gjatë asaj kohe, ai ka studiuar institucionet dhe organizimin Osman dhe në lidhje me to ka shkruar një vepër me shtatë vëllime. Ndër të tjera, D'Ohsson, tregon:

“Osmanët, e meritojnë të lavdërohen për virtytet e tyre, si nderi, drejtësia dhe ndershmëria, të cilat mbështeten në ligjet më të çmuara të Kuranit. Një nga virtytet e tyre që duhet lavdëruar, është edhe mbajtja e fjalës së dhënë.

“Mëshira (për të cilën flas), nuk është vetëm mëshira ndaj njëri-tjetrit që kuptoni ju. Përkundrazi, është mëshira që përfshin të gjitha krijesat.

(Po) Mëshira që përfshin të gjitha krijesat.”

(Hakim, IV, 185/7310.)





Ata do t'i vriste shumë ndërgjegjja nëse do të mashtronin ose do të përfitonin prej naivitetit të disa njerëzve, duke abuzuar me besimin e tyre. Kjo pjekuri që ka zënë vend në të gjitha sjelljet e tyre në marrëdhënie me njëritjetrin, shfaqet në mënyrë të njëjtë edhe ndaj të gjithë të huajve, të çfarëdo feje apo medh'hebi qofshin ata.

Në këtë pikë, ata nuk bëjnë dallime ndërmjet myslimanëve dhe jomyslimanëve, sepse ata e konsiderojnë haram çdo lloj fitimi të paligjshëm nga pikëpamja islame dhe besojnë në mënyrë të prerë se, një pasuri që nuk është fituar në rrugë të ligjshme, nuk do të ketë mirësi as në këtë botë dhe as në botën tjetër.”

Charles Mac-Farlane është një armik i Osmanëve, megjithatë ai nuk mund të rrijë pa e treguar këtë gjë mbresëlënëse:

“Miku im M. W., kishte një fshatar të varfër me emrin Buxhallë Mustafa, të cilin e përdorte shpesh si korrier midis Çeshmes dhe Izmirit në stinën e pjekjes së frutave.

Mustafai ngarkonte torbat me flori dhe në të shumtën e rasteve nisej prej Izmirit në mbrëmje. Ai udhëtonte gjithë natën duke kapërcyer male të thepisura dhe pasi përshkonte rreth 150 km, mëngjesin tjetër arrinte në Çeshme me ngarkesën e tij të çmuar. (...)

Në jetën tonë duhet të përpiqemi me dashuri e dëshirë të flaktë si sahabët dhe gjyshërit tanë, për të marrë hisen tonë prej frymëzimit shpirtëror të Profetit (a.s.).





Ajo që të bën habi këtu, është se nuk kishte ngelur askush që nuk e njihte atë dhe të mos e dinte se çfarë ngarkese kishte. Asnjëri nga tregtarët e Izmirit nuk nguronte të dërgonte paratë e tij gjatë një rruge kaq të rrezikshme...”

Qoftë për shkak të vullnetit hyjnor që sundon historinë, qoftë për shkak të mosedukimit të brezave idealë që do të ishin flamurtarë të Islamit në të shkuarën dhe gjatë shekujve të fundit, ndodhi që myslimanët mbetën pas nga hapja e horizonteve dhe zemrave të reja, duke u fokusuar vetëm në problemin e mbrojtjes dhe ruajtjes së kufijve ekzistues.

Pavarësisht prej mangësive në aspektin e shkollimit, për shkak se besimi dhe shpirti i popullit ishte ende i mbushur me dashurinë për luftën në rrugë të Allahut, edhe lufta e tij e fundit ishte e mahnitshme.

FITTORJA E ÇANAKALASË

Në këtë luftë, Britania e Madhe (që përfshinte Australinë dhe Indinë), Franca dhe Italia, sulmuan një copë të vogël toke që ishte si një mur me mburojë çeliku, për të kaluar në fillim prej detit, pastaj prej tokës. Populli kishte një vijë kufitare të përbërë vetëm prej zemrës së mbushur me besim tek Allahu, të cilën e mbrojtën me jetët e tyre, aq sa doli edhe shprehja:

Shpata zhdukte vetëm padrejtësinë, thyente dyert e burgjeve dhe i shërbente misionit të largimit të pengesave midis njerëzve drejt rrugës së vetme të lumturisë së përgjeshme, Islamit.





“Çanakalaja nuk kalohet!”

Këto rreshta prej letrës së një ushtari të luftës së Çanakalasë, përmbledhin qëllimin e pandryshueshëm që prej luftës së Bedrit:

“O Allah i Madhëruar!

E gjithë dëshira e këtyre ushtarëve trima, është t’ua prezantojë emrin Tënd të bukur anglezëve dhe francezëve.

Na e plotëso këtë dëshirë fisnike dhe na i mpreh bajonetat e ushtarëve të cilët po të luten Ty në këtë vend të bukur e të qetë, duke u dridhur para Teje. Ti i ke poshtëruar armiqtë e Tu, por shkatërroji plotësisht!..”

Ndërsa një dëshmitar prej ushtarëve anzakë, e tregon kështu sjelljen e njerëzishme të Osmanëve ndaj robërve të luftës:

“Me gjithë epërsinë teknologjike, mundësive dhe të numrit tonë, ne zbrapseshim vazhdimisht përballë guximit dhe përpjekjeve të Osmanëve, pastaj sulmonim përsëri. Në një nga këto sulme, unë u godita rëndë në kokë nga një qytë dhe më ra të fikët.

Kur erdha në vete, e kuptova se ndodhesha midis osmanëve. Në fillim më hyri frika, sepse anglezët na kishin thënë se osmanët janë njerëz të egjër e barbarë.

Madje, edhe pas shumë shekujsh, presidenti hungarez Pal Schmitt, e ka kujtuar me mirënjohje faktin se shkaku i vetëm i mbijetesës së popullit të tij, ishte qëndrimi i tyre për 150 vite nën administrimin e Osmanëve.





Mirëpo, kur erdha mirë në vete, pashë se plagët e mia ishin të lidhura me fashë dhe më kishin mjekuar. Unë nuk vëreja urrejtje ndaj meje në fytyrën e asnjërit prej tyre. Mbi të gjitha, ata më dhanë edhe ushqime prej çantave të tyre. Unë e dija mirë se ushqimet ishin aq të pakta, madje mund të thuhet se s'kishin fare. Aty përjetova një habi që më shokoi. Këtu isha pothuajse si një mysafir. Tashmë thosha me vete:

“Turp për mua! Turp për anglezët gënjeshtarë!”

Ndërsa bota, gjoja e qytetëruar, që shekullin e fundit kishte arritur fuqi teknologjike, nuk arriti të shfaqë asnjëherë qoftë edhe rregullat më themelore të ligjeve të luftës, ashtu siç i shfaqën ushtritë fituese islame. Me barbarinë që treguan, ata u bënë të njohur si një civilizim grabitqar, pa ndjenja, hiena të zbukuruara dhe të maskuara.

NJË CIVILIZIM BARBAR...

Dje, ata sulmuan në mënyrën më të pashpirt, në Andaluzi, në Ballkan, në Krime, në Azinë e Mesme, në Afrikë dhe sot po ashtu, po sulmojnë në Lindjen e Mesme, në Siri, në Arakan, në Afganistan, në Kashmir dhe në çdo vend ku gjendet popullsia e vuajtur dhe e shtypur myslimane.

Bota perëndimore që mori si parim humanizmin që solli filozofia, në luftë hedhin raketa dhe bombardojnë fshatrat e qytete. Aty ku bie bomba, djeg e përcëllon këdo që të kapë, gra, fëmijë, pleq, të sëmurë apo doktorë qofshin.





Ata derdhën gjak pa bërë dallim në janë foshnja, gra apo pleq. Sulmuan nderin dhe përdhosën xhamitë. Mbrojtën tiranin dhe i mbyllën sytë ndaj të shtypurit.

Për të shtënë në dorë naftën, ata e konsideruan të lejueshme derdhjen e gjakut. Ata i mbushën anijet e tyre me afrikanët e pashpresë dhe i dërguan si skllevër në Amerikë. Atyre u dhanë ushqimin që hanë kafshët dhe jo atë që hanin vet.

Ky civilizim i maskuar, mbështeti kapitalizmin, që i bën të pasurit më të pasur dhe të varfrit më të varfër. Ky sistem i bëri njerëzit skllevër me dëshirë, duke i dënuar të punonin brenda një rrethi të ndyrë që s'ka fund, vetëm për të paguar borxhet e kredive dhe kamatave të tyre.

Po ashtu, ata e shkatërroan familjen me anë të një lirie egoiste, e bënë shoqërinë narkomane, të alko-olizuar dhe të zhytur në kumar, duke i lënë brenda një dhune të gjithanshme. Ndërsa gruan e bënë një mjerane të rrugicave, duke e kthyer në një përfitim të ndyrë tregtar.

Me anë të televizionit, mediave dhe internetit, ata treguan edhe poshtërsinë e prezantimit të botës së tyre të mjerë si një "lumturi e vërtetë". Për fat të keq, në sajë të këtyre mënyrave mashtruese, e kapërcyen edhe Çanakalanë, na hynë edhe në shtëpi, edhe në xhepat tanë, edhe në vendin e punës, duke na pushtuar zemrat dhe mendjet tona.

Ky civilizim i maskuar, në botën e tyre mbështetën kapitalizmin, që i bën të pasurit më të pasur dhe të varfrit më të varfër.

Ky sistem i bëri njerëzit skllevër me dëshirë, duke i dënuar të punonin brenda një rrethi të ndyrë që s'ka fund, vetëm për të paguar borxhet e kredive dhe kamatave të tyre.





Brezi i sotëm, nuk i llogarit gjyshërit që ranë dëshmorë pa iu dridhur syri, për të mos e lënë armikun të shkelë atdheun, të prekë nderin dhe të ndalojë ezanët. Kujt i ngjajnë sot nipërit e atyre gjyshërve fisnikë, në aspektin e zemrës e të besimit, në atë të ideve e të mendimit, të ndërgjegjes dhe mënyrës së sjelljes?

LIGJI I LUFTËS NË ISLAM

Pikësëpari, duhet theksuar se, në përgjithësi, luftërat e Profetit (a.s.), kanë qenë për mbrojtje. Ashtu siç ka ndodhur në luftën Bedrit, në luftën e Uhudit dhe në luftën e Hendekut, edhe lufta e Mutes dhe e Tebukut, kanë qenë luftëra mbrojtëse, të cilat janë zhvilluar për të eliminuar përpjekjet e një sulmi të mundshëm. Ndërsa çlirimi i Mekës, është realizuar në bazë të idesë së rimarrjes së të drejtave që u ishin grabitur myslimanëve dhe për shkak se mekasit shkelën marrëveshjen që kishin bërë me myslimanët.

Domethënë, në themel të të gjitha luftërave të “Profetit të mëshirës”, ka mbizotëruar botëkuptimi i një mëshire dhe drejtësie gjithëpërfshirëse, duke u bërë mëshirë për të gjithë njerëzimin. Për këtë arsye, Islami, i cili ka si parim ruajtjen e paqes, edhe në situatat kur lufta është e domosdoshme, ka ligjëruar një ligj lufte shumë delikat.

Në Islam, është e ndaluar, haram, të luftosh për derdhur gjak dhe për të grabitur toka. Shpata përdoret vetëm për të eliminuar padrejtësitë dhe për t'i hapur rrugën udhëzimit. Një shpatë që nuk i shërben këtij qëllimi, është vetëm një copë hekur.





Në Islam, është e ndaluar, haram, të luftosh për derdhur gjak dhe për të grabitur toka. Shpata përdoret vetëm për të eliminuar padrejtësitë dhe për t'i hapur rrugën udhëzimit. Një shpatë që nuk i shërben këtij qëllimi, është vetëm një copë hekur.

Edhe në një luftë që zhvillohet për shkak të një situatë të detyrueshme, Profeti (a.s.), ka urdhëruar të mos preken gratë, fëmijët, të moshuarit, të mbjellat dhe ata që ndodhen në kisha apo manastire. Lufta bëhet vetëm ndaj atyre që u hapin luftë ushtarëve Islam.

Urdhrat e Profetit të mëshirës, janë të qarta:

“Luftoni në rrugën e Allahut me emrin e Tij dhe përleshuni me ata që nuk e njohin (e mohojnë) Allahun!

Mos e tradhtoni plaçkën e luftës!

Mos bëni padrejtësi dhe mos torturoni duke prerë veshë, hundë dhe gjymtyrë të tjera!

Mos vrisni fëmijë!” (Muslim, Xhihad, 3; Ahmed, V, 352, 358.)

“Mos vrisni fëmijët, njerëzit që rrinë në vend-adhurimet e tyre dhe merren me adhurime, gratë, të moshuarit dhe njerëzit që janë pajtuar për punë të tjera jashtë luftës!

Mos i digjini e mos i shkatërroni kishat. Mos i prisni pemët me gjithë rrënjë!” (Buhari, Xhihad, 148)

Profeti ynë (a.s.), ka urdhëruar që, në luftë, të mos preken gratë, fëmijët, të moshuarit, të mbjellat dhe ata që ndodhen në kisha apo manastire. Lufta bëhet vetëm ndaj atyre që u hapin luftë ushtarëve Islam.





Gjithashtu, është e ndaluar të preken edhe ata që gjatë luftës kërkojnë mëshirë dhe dorëzohen.

MASHTRIMI I HUMANIZMIT...

Ky është humaniteti që solli Islami. Ndërsa bota perëndimore që mori si parim humanizmin që solli filozofia, në luftë hedhin raketa dhe bombardojnë fshatrat e qytete. Aty ku bie bomba, djeg e përcëllon këdo që të kapë, gra, fëmijë, pleq, të sëmurë apo doktorë qofshin. Sot, bota po përjeton mizorinë e teknologjisë. I forti shtyp, i dobëti vuan.

Humanizmi është pothuajse asgjë përballë vlerës që Islami i ka dhënë njeriut...

Ky civilizim i maskuar, në botën e tyre mbështetën kapitalizmin, që i bën të pasurit më të pasur dhe të varfrit më të varfër. Ky sistem i bëri njerëzit skllëvër me dëshirë, duke i dënuar të punonin brenda një rrethi të ndyrë që s'ka fund, vetëm për të paguar borxhet e kredive dhe kamatave të tyre.

Po ashtu, ata e shkatërruan familjen me anë të një lirie egoiste, e bënë shoqërinë narkomane, të alkoolizuar dhe të zhytur në kumar, duke i lënë brenda një dhune të gjithanshme. Ndërsa gruan e bëri një mjerane të rrugicave duke e kthyer në një përfitim të ndyrë tregtar.

Në ç'gjendje është sot vetëdija e unitetit dhe bashkimit dhe ai entuziazëm vëllazëror që ishte dje, në luftën e Çanakalase? Sa arrijnë zemrat tona tek vëllazërit tanë në gjendje të keqe e të rrethuar nga zjarri në Siri dhe në vende të tjera?





Me anë të televizionit, mediave dhe internetit, ata treguan edhe poshtërsinë e prezantimit të botë së tyre të mjerë si një lumturi të vërtetë.

Për fat të keq, në sajë të këtyre mënyrave mashtruese, e kapërcyen edhe Çanakalanë, na hynë edhe në shtëpi, edhe në xhepat tanë, edhe në vendin e punës, duke na pushtuar edhe zemrat dhe mendjet tona.

Brezi i sotëm, nuk i llogaritën gjyshërit e tyre që ranë dëshmorë pa iu dridhur syri, për të mos e lënë armikun të shkelë atdheun, të prekë nderin dhe të ndalojë ezanët. Kujt i ngjajnë sot nipërit e atyre gjyshërve fisnikë, në aspektin e zemrës dhe të besimit, në atë të ideve dhe mendimit, të ndërgjegjes dhe mënyrës së sjelljes?

NË GJURMËT E KUJT JANË...

A gjenden sot të njëjtat botëkuptime me të njëjtën freski tek nipërit e atyre trimave që dje sakrifkuan jetën për Allahun, atdheun, bashkimin dhe nderin? Apo mos ndoshta janë zbrazur nga brenda dhe janë mbushur me mendime të huaja?

Sipas cilave kritereve nuk ua japin djersën e ballit punëtorëve të tyre sot bijtë e atij brezi sakrifkues e vetëmohues që dje i dilte për zot rob të luftës e

Luftërat e Profetit (a.s.), kanë qenë për mbrojtje. Ashtu siç ka ndodhur në luftën Bedrit, në luftën e Uhudit dhe në luftën e Hendekut, edhe lufta e Mutes dhe e Tebukut, kanë qenë luftëra mbrojtëse, të cilat janë zhvilluar për të eliminuar përpjekjet e një sulmi të mundshëm.

Ndërsa dërimi i Mekës, ndodhi për shkak se mekasit shkelën marrëveshjen që kishin bërë me myslimanët.





skllavit, duke i dhënë ushqimin më të mirë që hante vetë dhe duke e veshur me atë që vishej vetë?

A ruhet edhe sot e njëjta ndjeshmëri nga ana e tregtarëve në lidhje me hallallin, haramin, hakun e Allahut dhe të robrit, ashtu siç veprohej dje kur gjyshërit e tyre ruheshin edhe prej mashtrimit të jomyslimanëve?

Në çfarë gjendjeje është sot ajo vetëdije bashkimi, ajo vëllazëri dhe ai entuziazëm që ekzistonte dje në Çanakala?

Sa ndihet në zemra rënkimi dhe vuajtja e heshtur e mijëra të përvuajturve që po trondisin botën? Sa po u japim zemër vëllezërve tanë që gjenden sot në mjerim, brenda një rrethi të zjarrtë, atje në Siri dhe vende të tjera të ngjashme?

Sa jemi në të njëjtën linjë me sahabët dhe gjyshërit, të cilët plot entuziazëm shkuan në vendet që sot vuajnë nga uria materiale dhe shpirtërore, si në Afrikë, Ballkan, Azi të Mesme etj.?

Çfarë përgjegjësie kemi për të mos e kaluar dhe për të mos e lejuar shkeljen e “kufirit të Allahut”?

Allahu i Madhëruar, na e bëftë të mundur t’u përgjigjemi këtyre pyetjeve në mënyrën më pozitive.

Zgjidhja e vetme për të arritur këtë, është të zba-

Për fat të keq, në sajë të këtyre mënyrave mashtruese, e kapërcyen edhe Çanakalanë, na hynë edhe në shtëpi, edhe në xhepat tanë, edhe në vendin e punës, duke na pushtuar edhe zemrat dhe mendjet tona.





tojmë Sunetin e Profetit (a.s.), në jetën tonë dhe të përpiqemi me dashuri e dëshirë të flaktë si sahabët dhe gjyshërit tanë, për të marrë hisen tonë prej frymëzimit shpirtëror të Profetit (a.s.).

O Zot!.. Na bëj neve dhe pasardhësit tanë njerëz të kumtimit të fesë dhe shërbimit, të cilët janë të aftë ta shprehin drejtësinë, ëmbëlsinë, mëshirën, bukurinë e Islamit tek njerëzit, në rolin e dëshmitarëve të Tu dhe të së vërtetës!..

O Zot! Na bëj prej besimtarëve të ndërgjegjshëm e të butë, që derdhin lot dhe djersë, që ngrysen dhe gdhihen për Ty e për të vuajturit prej umetit të Muhamedit (a.s.)!..

Amin!..



“...u thoni fjalë të mira njerëzve”

(Bekare, 83)





VETËM DEVOTSHMËRIA...



*İslâm'ı Fahr-i Kâinat Efendimiz ve ashâbı
gibi yaşamak. Yani İslâm'ı kalbî derinliğiyle,
ahlâkî zarâfetiyle yaşamak zarûrî.*

*Her medeniyet, kendi insan tipini vücuda getirir.
O insan tipi de, mensup olduğu medeniyetin sıfat
ve karakterleriyle âhenk arz eder.*

*İslâm medeniyeti, insanlık tarihinde bir kere
ulaşılabilmiş bir zirvedir.*



VETËM DEVOTSHMËRIA...

ISLAMI: FEJA E VËRTETË

Feja e vetme e pranuar nga Allahu i Lartësuar është feja islame...

Ne erdhëm të udhëzuar në këtë jetë si pasojë e mëshirës së Allahut. Ne kemi ardhur në këtë botë të udhëzuar si një mirësi e madhe e Allahut Teala, por Allahu i Madhëruar na urdhëron të japim shpirt si myslimanë, sepse kjo nuk ka garanci.

Për këtë arsye, është kusht që të jetojmë vetëm me devotshmëri.



Nëse nuk duam që të na rrëshqasin këmbët nga rruga e drejtë, atëherë duhet ta zbatojmë këtë kusht.

Siç dihet, feja islame është e përsosur dhe madhështore si sistem. Tek ajo asnjëherë nuk kanë vend komentet sipas dëshirës dhe këndvështrimet e pabaza. Por ja që në ditët e sotme, për fat të keq, ka nga ata që e komentojnë Islamin sipas dëshirave, epsheve dhe interesave të tyre. Atëherë, cili është Islami që duhet të zbatojmë, në mënyrë që Zoti (xh.sh.), të jetë i kënaqur me ne?!

Ai është Islami që e ka zbatuar Krenaria e Gjithësisë, Profeti (a.s.) dhe sahabët e tij të nderuar.

Islamin duhet ta përjetojmë me thellësinë e zemrës dhe hijeshinë e moralit të lartë.

Ky është vetë Islami, por për ta ndarë nga këndvështrime të ndryshme, quhet: devotshmëri, asketizëm, ihsan, tasavvuf. Të gjitha këto janë emërtimet e ndryshme të së njëjtës të vërtetë.

Nisur nga kjo pikëpamje, veçanërisht në ditët e sotme, nevoja që njerëzit kanë për tasavvufin (mistikën) është në pikën më kulminante të saj, sepse feja mund të mbrohet vetëm me devotshmëri.

Devotshmërisë, nëse do t'i bënim përkufizimin më të shkurtër, është frika dhe dashuria ndaj Allahut Teala...

*Për ta falur namazin me sinjeritet e vetëdije,
devotshmëria është kusht, tasavvufi është kusht
dhe vetëdija e ihsanit është kusht.*





Kur Allahu Teala i përkufizon besimtarët, thotë:

“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata të cilëve

وَجَلَّتْ قُلُوبُهُمْ

u fërgëllojnë zemrat e tyre kur përmendet Allahu...”

(Enfal, 2)

Devotshmëria është të përjetuarit e Islamit me një zemër të butë e të ndjeshme, që dridhet nga frika ndaj Zotit (xh.sh.). Devotshmëria përmban shumë çështje brenda vetes:

NJË NAMAZ ME FRIKË E RESPEKT NDAJ ZOTIT

Kur të takohemi me Allahun e Lartësuar, pra në namaz, zemra dhe trupi duhet të jenë në harmoni me njëri-tjetrin.

Namazi është shumë i rëndësishëm. Ai duhet të falet me frikë e respekt ndaj Zotit (xh.sh.), në mënyrë të vazhdueshme dhe të kujdesshme, në mënyrë që ai namaz ta mbajë larg dhe ta mbrojë falësin e tij nga çdo lloj ligësie dhe vepre të shëmtuar.

Për ta falur namazin me këtë ndjeshmëri, sinqeritet e vetëdije, devotshmëria është kusht, tasavvufi është kusht dhe vetëdija e ihsanit është kusht.

Nëse i hedhim një sy historisë, vëmë re se njeriu që ka luftuar më së shumti me terrorin është i Dërguari i Allahut (a.s.).

Ëjeta profetike njëzet e tri vjeçare e tij, nga njëri aspekt, ishte luftë me terrorin. Terrori kundër njeriut, terrori kundër kafshëve, terrori kundër bimëve.





Allahu i Lartësuar më së shumti na drejtohet me emrat e Tij “Mëshirues” dhe “Mëshirëbërës”. Nisur nga kjo, Ai dëshiron që edhe ne të mbushemi plot me mëshirë dhe të stolisemi me bujari. Kur Krijuesi i përkufizon besimtarët e devotshëm, thotë:

“...Ata japin nga ajo që Ne u kemi dhënë.” (Bekare, 3)

Për ta fituar këtë cilësi të lartë, e kemi kusht që të shpëtojmë nga koprracia dhe pangopësia e nefsit. Rruga që të shpie te kjo është tasavvufi.

Allahu Teala kërkon nga ne nder, drejtësi, trimëri, mirësjellje dhe hijeshi. Gjithashtu kërkon që t'i respektojmë të drejtat e njeriut.

Për t'i arritur këto, në zemër duhet të gjendet vetëdija se robi vazhdimisht është nën vëzhgimin e kamerave hyjnore, pra, ihsani është kusht. Duhet të zhduken sjelljet arrogante të nefsit dhe të nxirren në pah aftësitë shpirtërore, prandaj devotshmëria është kusht.

Në të kundërt, del në pah mungesa e sinqeritetit, shtirja, vesi, injoranca, koprracia, papërgjegjëshmëria. Pastaj këto bëhen objekt që tërheqin vëmendjen e armiqve dhe shpifësve për Islamin.

Përfundimisht, Zoti (xh.xh.), kërkon nga ne një natyrë njerëzore të përsosur.

*Mendimtari perendimor Thomas Carlyle thotë:
Për nga mëdhështia, nderimi dhe respekti, asnjë mbret me
kurorë në botë nuk mund të krahasohet
Muhamedin (a.s.) i cili arrinte vetë rrobën e tij.*





Allahu i Lartësuar thotë kështu duke na sqaruar se si mund ta arrijmë këtë natyrë njerëzore të përsosur:

إِنَّمَا يَخْشَى اللَّهَ مِنْ عِبَادِهِ الْعُلَمَاءُ

“...Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët...” (Fatir, 28)

Ne duhet të përsosim një dije të tillë që të na e shtojë frikën e respektin ndaj Allahut Teala, të na e shtojë thellësinë e meditimit, të na bëjë t'i shikojmë rrymat e fuqisë dhe madhësisë hyjnore dhe të na bëjë të themi: “Aman o Zot!”

NJË DIJE E TILLË QË...

Një dije e tillë që të na bëjë të meditojmë rreth ajeteve të Kuranit Fisnik dhe argumenteve të librit të gjithësisë. Në këtë mënyrë, të na japë një bazë për “marifetullahin (njohjen) e Allahut”.

Allahu i Madhëruar i ka dhënë njeriut dijet ekzoterike dhe ezoterike. Të gjitha dijet, duke filluar nga mjekësia e deri tek astronomia, nga botanika e deri te biologjia, nga fizika e deri te kimia, përbëhen nga rregulla të mësuara si rezultat i përpjekjeve shekullore të njerëzve në lidhje me njohjen e sistemit të gjithësisë, të cilën e ka krijuar Allahu.

*Madje edhe një jomusliman si filozofi francez Lafajet përballë madhësisë së Muhamedit(a.s) u detyrua të thoshte:
“O Muhamed! Atë që ti ke prurë dhe aplikuar në botë,
nuk e ka bërë askush tjetër. Ti e ke sjellë drejtësinë
në një vend të paarritshëm!...”*





Këto dije janë si një thikë me dy tehe të mprehta dhe mund të shërbejnë edhe për të mirë, por edhe për keq.

Shërbimi për të mirë është i njohur:

Qëllimi i këtyre dijeve duhet të jetë përgatitja e një baze për “marifetullahun”. Ato duhet t’ia shtojnë meditimin njeriut dhe ta bëjnë që të vështrojë madhësitinë, fuqinë dhe mëshirën hyjnore.

Dija bashkë me devotshmërinë duhet ta afrojë robin tek Allahu i Plotfuqishëm dhe ta shpjerë atë tek “marifetullahu”. Në çdo rregull të dijës dhe në çdo shfaqje të saj, robi duhet të kujtojë madhësitinë dhe fuqinë absolute të Allahut Teala.

Si mund të dalë një pemë madhështore nga një farë dhe si mund të japë frute me tonelata? Si mund ta fshehtë ajo farë planin dhe programin e të fshehtës së formimit të kësaj peme?

Si mund të dalë nga veza një zog apo gjallesë tjetër?

Po njeriu? Si formohet nga një grimcë? Cila fuqi i ruan të gjitha organet në atë grimcë?

Meditimi është një çelës i besimit. Edhe dija duhet të jetë produkt i meditimit.

*Islamin duhet ta përjetojmë
me thellësinë e zemrës dhe hijeshinë
e moralit të lartë.*





Fryti material i një dijeje të tillë duhet të jetë shkak për shpërthimin e mëshirës te njeriu. Fryti shpirtëror i dijes duhet të jetë lartësim i Allahut dhe fryti material i saj duhet të jetë mëshirë ndaj të gjitha krijesave nga ana e njeriut. Për shembull, mjekësia duhet të shërbejë për shërimin e njeriut. Shkenca duhet ta mbrojë mjedisin, njeriun, natyrën dhe të gjitha krijesat e tjera.

Për fat të keq, sot nuk po ndodh kështu, sepse aktualisht tehu tjetër i mprehtë i dijes po i shërben më shumë së keqes.

Dija po shkëputet nga “marifetullahu”. Për shkak të kësaj, po dalin njerëz që bëjnë hamallëkun e dijes, por që nga kjo nuk shohin asnjë dobi të tillë si: meditimi, devotshmëria, frika, respekti ndaj Zotit e mëshira ndaj njerëzve apo krijesave të tjera. Këta hamallë të dijes nuk janë dijetarë, por në të vërtetë janë dijetarë të rremë. Për shkak të kësaj po dalin në pah zemra të nxira dhe të mbytura në rreshtat e zinj të librave me kopertina të errëta.

Allahu i Madhëruar thotë kështu në lidhje me këta hamallë të një dijeje të tillë:

“...i shëmbëllen gomarit, që vetëm sa i mbart librat...” (Xhuma, 5)

Ky është një shpërdorim dëshpërues i dijes. Ky është një diamant i hedhur në rrugë. Kjo është një fatkeqësi.

Ai gjithmonë i ka zbatuar të drejtat e njerëzve qofshin besimtarë apo jobesimtarë. Si rezultat, shkretëtirat e shndërruara në liqene gjaku i bëri vende të qeta dhe hodhi themelet e një qytetërimi virtytësh të pashoqe, që historia njerëzore nuk e kishte parë kurrë.





Në vend që dija të bëhet shkak për shtimin e dashurisë e besimit ndaj Allahut Teala dhe “marifetullahut”, përkundrazi, po bëhet shkak për mburrjen, mendjemadhësinë, urrejtjen dhe padrejtësinë.

Një pjesë e rëndësishme e dijetarëve ekzoterikë të sotëm janë mashë e të padrejtëve. Si rezultat, kanë shpikur armë që vrasin më shumë njerëz dhe kanë nxjerrë shkencëtarë që janë militantë të tiranëve. Ndotja, e cila ka zhdukur shumë lloje gjallesash në tokë e në det, është rezultat i teknologjisë së nënshtruar ndaj interesave të kësaj bote.

Dijet ekzoterike duhet të përdoren në mënyrë të drejtë e të saktë.

JO QËLLIM, POR OBJEKT PËR TË ARRITUR TE QËLLIMI

Pikërisht si Lejla për Mexhnunin...

Dijet janë si Lejla në historinë e Lejlës dhe Mexhnunit. Nëse Mexhnuni do të rrinte gjithmonë pas Lejlës, nuk do të shprehte asgjë dhe fundi i tij do të ishte tragjik. Por ngaqë Mexhnuni e bëri dashurinë ndaj Lejlës së përkohshme shkallë për të shkuar te dashuria e Zotit të Përhershëm, arriti virtytin, arriti takimin hyjnor, arriti urtësinë.

*Sot bota gjendet në një zbrazëti të madhe
dhe njerëzimi nën vrazhdësinë e tmerrshme të jetës
lakmitare. Cila është rrugëzgjdhja?
Rrugëzgjdhja është Islami.*





Edhe në dije, ajo që e shpie njeriun te virtyti është dija e dobishme. Dobia e dijes matet se sa mund ta shpjerë të zotin e saj me devotshmëri të Allahu i Madhëruar. Allahu i Gjithëmëshirshëm thotë:

وَاتَّقُوا اللَّهَ وَيُعَلِّمُكُمُ اللَّهُ

“...ruajuni Allahut (jini të devotshëm)! Allahu ju mëson (ato që nuk i dini)...” (Bekare, 282)

Domethënë, na dhuron shfaqje nga “marifetullahu”.

Në ditët e sotme, bota globale vazhdon ta ndyjë ndërgjegjen e njerëzve dhe t’ua nxisë ambiciet atyre. Nëse u hedhim një sy vendeve në të cilat derdhet gjak, shihet qartë se pas perdes ka luftë për naftë dhe për interesat e kësaj bote. Gjaku i njerëzve po derdhet lumë për të marrë naftë me fuçi.

Ja gjendja e Sirisë... Me miliona drama para syve të botës... Askush nuk përpiqet ta ndalojë padrejtësinë dhe gjakun, në mënyrë që të mos u preken interesat e tyre.

Sot bota gjendet në një zbrazëti të madhe dhe njerëzimi nën vrazhdësinë e tmerrshme të jetës lakmitare.

Cila është rrugëzgjdhja?

Rrugëzgjdhja është Islami.

Profeti (a.s.) thotë:

Nëse, pa dashje kam marrë pasurinë e dikujt, këtu është pasuria ime le të vijë ta marrë... Kë kam qëlluar me pa të drejtë le të vijë të marrë hakun...

(Ahmed, III, 400)





Islami me natyrën, tasavvufin dhe devotshmërinë e vërtetë.

Për ta bllokuar edhe këtë rrugëdalje, kanë nxjerrë në pah një fenomen që e quajnë islamofobi.

ÇËSHTJA E ISLAMOFOBISË

Në ditët e sotme, ata që duan ta ndalojnë përparimin e Islamit në shkallë botërore, për fat të keq kanë formuar një dallgë të shëmtuar urrejtjeje dhe armiqësie kundër Islamit dhe myslimanëve të cilën e quajnë “Islamofobi”. Tashmë një pjesë e njerëzve, qoftë nga padituria, qoftë nga nijeti i keq, fjalën “Islam” kanë filluar ta përdorin bashkë me fjalën “terror”. Kjo është një prej katastrofave më të mëdha të kohës sonë.

Ndërkohë terrori është i ndërtuar mbi tiraninë. Terroristët asnjëherë nuk kanë nevojë për ndjenja sublimë si edukata, morali, dashuria e frika ndaj Allahut Teala. Terrori nuk ka lot, nuk ka mëshirë, nuk ka ndërgjegje.

Ndërsa Islami është plotësisht e kundërta e terrorit. Ai është i ndërtuar veçanërisht mbi butësinë dhe mëshirën. Allahu i Lartësuar në Kuranin Fisnik më shumë përmend emrat e Tij si Rrahman dhe Rrahim, domethënë, shpreh mëshirën e Tij që përfshin të gjitha

*Profeti (a.s.) ndërsa edukonte shokët
nuk i dha në dorë laps dhe letër por i dha zemrën.
Vazhdimisht i mbrujti me devotshmëri.*





krijesat. Edhe i Dërguari i Allahut (a.s.), është dërguar si “mëshirë për botët”.

Nëse i hedhim një sy historisë, vëmë re se njeriu që ka luftuar më së shumti me terrorin është i Dërguari i Allahut (a.s.). Jeta profetike njëzet e tri vjeçare e tij, nga njëri aspekt, ishte luftë me terrorin. Terrori kundër njeriut, terrori kundër kafshëve, terrori kundër bimëve.

I Dërguari i Allahut (a.s.), gjithmonë ka luftuar me këto. Ai gjithmonë i ka zbatuar të drejtat e njerëzve qofshin besimtarë apo jobesimtarë. Si rezultat, shkretëtirat e shndërruara në liqene gjaku i bëri vende të qeta dhe hodhi themelet e një qytetërimi virtytesh të pashoqe, që historia njerëzore nuk e kishte parë kurrë. Ai gjithmonë përhap mëshirë dhe butësi kundër çdo lloj terrori.

Sot, ajo që na takon të bëjmë si umeti i Muhamedit (a.s.), është përjetimi aq sa kemi mundësi i moralit të lartë të Pejgamberit (a.s.), i cili ishte mëshirë për botët, reflektimi i atij morali në veprat tona dhe predikimi i tij. Përderisa ta kryejmë me sukses këtë detyrë as shpifjet, as ofendimet nuk kanë asnjë vlerë. Shpifësit nuk mund të gjejnë më mundësi për ofendime të tilla, sepse Islam do të thotë paqe. Islam do të thotë paqe për të gjithë njerëzimin.

*“Ata që janë më afër meje prej njerëzve,
janë të devotshmit kundrejt Allahut
kushdo qofshin dhe kudo qofshin ata.”*

(Ahmed, V, 235; Hejsemi, IX, 22.)





Shpifësit përpiqen ta shfaqin Islamin si terror dhe barbarizëm. Ata përpiqen ta akuzojnë Islamin përmes shembujve më negativë, të cilët në fakt janë shfaqur në batakun e jetës së tyre.

Ndërkohë Islami nuk është frikësues, por qetësues dhe rehatues i zemrës. Në të njëjtën kohë përhap mirësjelljen, ëmbëlsinë dhe hijeshinë. Islami është feja që lufton me çdo lloj terrori. Islami është feja që i trajton me butësi të gjitha krijesat. Ja disa shembuj nga vetë bahçja me trëndafila e Islamit:

KULMI I DHEMBSHURISË

Kur u nis udhës për në Mekë, Profeti (a.s.), doli prej Medinës i veshur me ihram. Udhëtuan derisa erdhën në një vend të quajtur Usaje, midis Ru'uejjes dhe Arxhit.

Aty, pa një sorkadhe që flinte nën një hije. Për këtë arsye, Profeti (a.s.), thirri menjëherë një person prej sahabëve dhe e urdhëroi të qëndronte pranë saj derisa të kalonin të gjithë, me qëllim që të mos ta trembnin apo ta shqetësonin. (Mu'uatta, Haxh, 79; Nesai, Haxh, 78.)

Po ashtu, edhe gjatë udhëtimit për në çlirimin e Mekës, në mes të rrugës vunë re një qen femër që ishte shtrirë përtokë për të ushqyer të vegjlit e saj me

"Shembulli i umetit tim është si shembulli i shiut, ndaj nuk i dihet nëse fillimi i tij është më i mirë apo fundi i tij! (Edhe fillimi, edhe fundi i tij është i mirë!)"

(Tirmidhi, Edeb, 81/2869; Ahmed, III, 130.)





qumësht. Profeti (a.s.), menjëherë thirri Xhuajl bin Surakan (r.a.) dhe e vendosi si roje pranë qenit dhe këlyshëve të saj, me qëllim që ata të mos shqetësoheshin nga asnjë njeri që do të kalonte aty. (Uakidi, II, 804.)

I Dërguari Fisnik (a.s.), ka thënë:

“Rrahmani (Mëshiruesi), i mëshiron njerëzit mëshirues. Mëshirojini ata që janë në tokë, që t’ju mëshirojnë ata që janë në qiell!” (Ebu Daud, Edeb, 58/4941.)

Kjo ndodhi, është një shembull i pashoq i shikimit të krijesave me syrin e mëshirës:

Një ditë, i Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

“Betohem në Allahun, i Cili ka në dorë jetën time, se nuk do të hyni në xhenet pa e mëshiruar njëri-tjetrin.” Sahabët thanë menjëherë:

“O i Dërguar i Allahut! Të gjithë jemi të mëshirshëm.” Ndërsa Profeti (a.s.), tha:

“-Mëshira (për të cilën flas), nuk është vetëm mëshira ndaj njëri-tjetrit që kuptoni ju. Përkundrazi, është mëshira që përfshin të gjitha krijesat. (Po) Mëshira që përfshin të gjitha krijesat.” (Hakim, IV, 185/7310.)

Një shembull të pashoq të kësaj mëshire të madhe e të pafund, e tregon edhe Bejazid-i Bistami:

Edhe në fund-kohë, do të vijë një lloj injorance si në fillim... Për rrjedhojë, sot, për shkak të internetit, televizionit, etj., njerëzit po lundrojnë në devijime, ashtu si trungjet gjatë përmbytjeve. Ndërsa brezi i mirë në fund të umetit, do ta ruajë besimin e vet dhe do ta eliminojë injorancën duke vazhduar xhihadin Islam.





“Në kohën tonë kishte me mijëra veli. Mirëpo, detyra e prijësit (në rrugën e drejtë) për atë shekull, i ishte besuar një hekurpunuesi me emrin Ebu Hafs. Për të mësuar më shumë rreth kësaj urtësie, shkova te dyqani i tij. Kur e pashë, vura re se ai ishte shumë i shqetësuar dhe i hidhëruar. E pyeta për arsyen e kësaj dhe ai mu përgjigj me këto fjalë:

“Vallë, a ka dert më të madh se derti im, dhe njeri më me shumë derte se unë? Vallë, si do të jetë gjendja e umetit të Muhamedit (a.s.), në Ditën e Kiametit?”

Më pas filloi të qante dhe më bëri edhe mua të qaja. U bëra kureshtar dhe e pyeta:

“Përse të shqetëson kaq shumë fakti se njerëzit do të dënohen?”

Ebu Hafsi u përgjigj:

“Natyra ime është mbujtur me mëshirë dhe dhembshuri. Nëse i gjithë dënimi që do t’u jepej njerëzve të shkujdesur do të binte mbi mua dhe ata do të faleshin, unë do të isha tepër i kënaqur prej kësaj dhe derti im do të merrte fund...”

Prej kësaj, kuptova se Ebu Hafsi nuk ishte nga ata që thoshin “unë, unë”, por duke qenë në rrugën e Profetit (a.s.), ishte nga ata që thoshin “umeti, umeti”.”

Nëse Mexhmuni do të kishte ndjekur Lejlën, nuk do kishte asnjë kuptim.

Fundi i tij do të ishte fatkeqësi. Mirëpo, për shkak se dashurinë për Lejlën e vdekshme e bëri shkallë për të arritur dashurinë e Zotit të pavdekshëm, Mexhmuni arriti virtytin e lartë.

Ai arriti takimin dhe urtësinë hyjnore. Në veprat e tasavufit, kjo gjendje e tij, është bërë një shembull i pashoq i udhëtimit drejt Zotit dhe takimit me Të.





Qëndrova edhe pak kohë pranë tij dhe mora shumë frymëzim shpirtëror prej tij. Unë kuptova se dashamirësia dhe dhuntia që kishte arritur, ishin begatia e butësisë dhe mëshirës së madhe, të cilat i kishte bërë natyrë të vetën. Prej tij mësova se çfarë është mëshira...”

Duhet menduar se:

Nëse një i dashur i Allahut është kështu, atëherë kushedi se si duhet të jetë dhembshuria dhe mëshira e të Dërguarit të Tij?

Padyshim që është shumë e madhe...

Ta pyesim veten:

Sa të mëshirës jemi ne umeti i një profeti që është dërguar si mëshirë për të gjitha botët?

Ai Profet i mëshirës, thotë:

“Bëni kujdes! Për sa kohë jam gjallë, jam shkak i sigurisë suaj. Por kur të ndërroj jetë, do t’i përgjërohem Zotit “O Zot, ummeti, ummeti!”, derisa t’i fryhet surit për herë të parë...” (Ali el-Muttaki, Kenzu’l-Ummal, V. 14, fq. 414.)

Në një hadith tjetër, Profeti (a.s.), thotë:

“Kujdes! Mos ma nxini fytyrën (duke bërë gjynahe)!..” (Ibn-i Maxhe, Menasik, 76.)

Urtësia që Allahu i Madhëruar i ka falur dije njerëzimit, është që robërit e Tij të njohin madhësitinë dhe lartësinë Allahut. Dija që nuk të çon në këtë qëllim, është cilësuar si: “Dije padobi”. Ndërsa i Dërguari i Allahut (a.s.), ka kërkuar strehim tek Allahu prej dijes së padobishme.





Ndërsa në një hadith tjetër, thotë:

“Shefaati (ndërmjetësimi) im do të jetë për ata prej umetit tim, të cilët kanë bërë gjynahe të mëdha.” (Ebu Daud, Sunnet, 20)

I Dërguari i Allahut (a.s.), pa dikë që po e çonte delen për ta therur duke e tërhequr për veshi. Menjëherë ndërhyri dhe i tha:

“Lëshoje veshin e kafshës dhe kape për qafe!” (Ibn Maxhe, Dhebah, 3.)

Sevade bin Rebi (r.a.), tregon:

“Shkova te i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe i kërkova disa gjëra. Ai urdhëroi që të më jepeshin 3 deri në 10 deve.

Pastaj më dha këtë këshillë:

“Kur të kthehesh në shtëpi, thuaju njerëzve të shtëpisë tënde që të përkujdesen mirë për kafshët dhe t’u japin mjaftueshëm ushqim.

Gjithashtu urdhëroi që t’i presin thonjtë, në mënyrë që të mos i lëndojnë dhe t’i gërvishtin gjinjtë e kafshëve kur t’i mjelin!” (Ahmed, III, 484; Hejsemi, V, 168, 259, VIII, 196.)

Një fe e cila urdhëron një mëshirë të tillë për krijesat, sigurisht që ka shfaqur butësi dhe mëshirë edhe për njerëzinë.

Kanë shpikur një fenomen të quajtur “Islamofobi”. Por Islam, do të thotë “paqe”. Paqe për gjithë njerëzimin... Mirëpo, shpifësit përpiqen që ta prezantojnë Islamin me të kundërtën e tij, që është dhuna dhe terrori. Në fakt, Islamin e njohim prej jetës profetike 23 vjeçare të të Dërguarit të Allahut (a.s.), ku shihet qartë se Islami është i gjithi mëshirë. Islami, i ka mësuar mëshirën të gjithë atyre që nuk e kanë njohur atë.





Profetit (a.s.), nuk i pëlqeu që sahabët të bënin muhabet hipur mbi kafshët e tyre dhe i këshilloi:

“Mos i përdorni kurrizët e kafshëve tuaja si po-diume!” (Ebu Daud, Xhihad, 55/2567.)

Ndërsa atyre që udhëtonin, u kujtoi që kafshët e tyre t’i pushonin në vende me kullota. Njëherë, kur pa një fole milingonash të djegur, u tmerrua dhe tha:

“Kush e dogji këtë fole milingonash, kush mund ta marrë jetën që ka dhënë Allahu?”

Atëherë, duhet menduar mirë se çfarë dhembshurie dhe mëshire ligjëron për njerëzimin një fe e cila urdhëron një mëshirë të tillë për krijesat.

Shkurtimisht, njerëzimi dhe krijesat e tjera gjetën paqe me Islamin. Ndërsa shkaku që ata zgjasin gjuhët e tyre ndaj Islamit, dihet:

E DAVËRTETA SHQETËSOHET NGA E VËRTETA

Ata që flenë në shkujdesje shqetësohen prej atyre që i paralajmërojnë.

Sot, njerëzit interesaxhinj dhe pragmatistë shqetësohen nga butësia, mëshira dhe altruizmi që predikon Islami.

*“...Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij... (Huxhurat, 13)
Ky ajet, është zbritur si një vërtetim hyjnor i virtytit të një skllavi.
Thelbi i kësaj devotshmërie, ishte respekti ndaj namazit dhe dashuria ndaj Resulullahut (a.s.).*





Islami i shqetëson të padrejtët e mashtruesit me drejtësinë dhe barazinë që urdhëron.

Kështu, në botën perëndimore, pohimi se civilizimi islam është i vetmi që mund të shfaqë rezistencë kundrejt civilizimit perëndimor, i cili gjendet në krye me fuqi materiale dhe se për këtë shkak do të ketë kontradikta e përplasje ndërmjet këtyre dy civilizimeve, ka filluar të thuhet që para 20-30 vjetësh.

Edhe pse myslimanët momentalisht janë shumë prapa perëndimit materialisht, politikisht, ushtarakisht, teknikisht dhe teknologjikisht, ata kanë frikë nga Islami. Përse?

Sepse Islami e ka ruajtur të vërtetën se jeta e vërtetë është Ahireti. Ata nuk kanë një përgjegjësi të tillë. Andaj kërkojnë një jetë argëtuese, të zakonshme dhe në përputhje me dëshirat e vetes.

Për këtë arsye, e sulmojnë Islamin, sepse ai e ndalon këtë.

Përveç të tjerash, edhe ata e dinë se interesi e shqetëson ndërgjegjen e njeriut. Njerëzia kërkon butësi dhe mëshirë.

Padrejtësia i plagos zemrat. Njerëzia po i drejtohet një feje që e urdhëron drejtësinë dhe që e mban gjallë atë.

*"...ruajuni Allahut (jini të devotshëm)!
Allahu ju mëson (ato që nuk i dini)..."*

(Bekare, 282)





Një jetë pa qëllime, një jetë shtazore dhe e çmendur, e lëndon shpirtin. Njeriu po kërkon qëllimin e ekzistencës së tij.

Këtij kërkimi i japin përgjigje myslimanët që e zbatojnë Islamin e vërtetë, myslimanët e sjellshëm dhe zemërbutë.

BAZA SHPIRTËRORE ËSHTË KUSHT

Në të gjitha dijet ekzoterike dhe ezoterike patjetër duhet të hyjë baza fetare.

Nëse brezave nuk u jepet feja, domethënë baza shpirtërore, ata ngelin si një civilizim me një këmbë të vetme, që ekranet dhe rrjetet e padukshme të internetit e kanë lidhur me zinxhirë njëra-tjetrën. Si rezultat, lidhja biologjike e prindërve nuk shpreh asnjë gjë.

Për këtë arsye, institucionet që do të hedhin fenë dhe themelet shpirtërore në botën e zemrave të fëmijëve tanë, janë shumë të rëndësishme.

Kurset e Kuranit, medresetë dhe të gjitha përpjekjet që jepen në këtë fushë janë shumë të rëndësishme.

Këto përpjekje janë shumë të rëndësishme për të edukuar një brez të devotshëm, që e zbaton Islamin dhe që do të bëhet dëshmitar i Zotit (xh.sh.), me vetëdijen e ihsanit...

*"Bëni kujdes! Për sa kohë jam gjallë,
jam shkak i sigurisë suaj. Por kur të ndërroj jetë, do t'i
përgjërohem Zotit "O Zot, ummeti, ummeti!", derisa t'i
fryhet surit për herë të parë..."*

(Ali el-Muttaki, Kenzu'l-Ummal, V. 14, fq. 414.)





Ata që edukohen me këtë bazë shpirtërore në këtë kohë të fundit dhe që mund ta vendosin dijen në vendin e saj të vërtetë e të dobishëm, mund ta reflektojnë fytyrën e qeshur të Islamit ndaj të gjithë botës. Ja, kjo është edhe frika e vërtetë e atyre që kanë shpikur Islamofobinë.

I Dërguari i Allahut (a.s.), thotë kështu duke e krahasuar pothuajse me sahabët brezin e myslimanëve që do të vijnë në kohën e fundit:

“Shembulli i umetit tim është si shembulli i shiut, ndaj nuk i dihet nëse fillimi i tij është më i mirë apo fundi i tij! (Edhe fillimi, edhe fundi i tij është i mirë!)”

(Tirmidhi, Edeb, 81/2869; Ahmed, III, 130.)

Po, brezat që vijnë duhet t’i edukojmë me rregullat e devotshmërisë që kanë pasur sahabët e nderuar.

SI SAHABËT

Koha e sotme është e mbushur plot me vështirësi. Kështu që në kohët e vështira, ajo që e shpëton njeriun është vetëm devotshmëria.

Kur Profeti (a.s.), i edukoi sahabët e tij, askujt nuk i dha në dorë letër dhe laps. Atyre u dha zemër. U dha një zemër të pastër. Ai gjithmonë i inkurajoi që të ishin të devotshëm. Ndër të tjera ka thënë:

Dija është trashëgimia më e mirë. Morali është arti më i mirë. Devotshmëria është ushqimi më i mirë. Tbadeti është kapitali më i mirë.





“Ata që janë më afër meje prej njerëzve, janë të devotshmit kundrejt Allahut kushdo qofshin dhe kudo qofshin ata.” (Ahmed, V, 235; Hejsemi, IX, 22.)

Edukimi që dha ai, ishte një dije e përjetueshme që transmetohej jo nga rreshtat, por nga zemrat.

Edhe sahabët, të cilët morën këtë edukim të veçantë, e bënë të gjithë sipërfaqen e kësaj bote nga Semerkandi e deri në Afrikën Veriore shkollë të kësaj dijeje shpirtërore të dobishme. Sot në çdo vend ku kanë arritur përpjekjet e frytshme dhe të begata të atyre, duket Islami.

Ja pra, edhe ne duhet ta trashëgojmë këtë dije dhe t’ua transmetojmë brezave të ardhshëm.

Edhe sot, një nënë dhe baba i mëshirshëm, një nënë dhe baba që dëshiron t’i lërë trashëgimi fëmijëve të tyre, të mos harrojnë se trashëgimia më e rëndësishme është trashëgimia e botës tjetër.

Në hadithin fisnik thuhet:

“Prindërve të atij që e lexon Kuranin Fisnik dhe punon me të, Ditën e Gjykimit do t’u vihet një kurorë. Drita e kësaj kurore është më e bukur se drita që jep dielli kur bie në një shtëpi në këtë botë. Atëherë, pa mendoni se si mund të jetë drita e atij që punon vetë me Kuranin Fisnik?” (Ebu Davud, Vitri, 14.)

Profeti (a.s.) thotë:

Allahu mëshiron të mëshirshmit.

Mëshironi ata që janë në tokë në mënyrë që t’ju mëshirojnë ata që janë në qiell.

(Ebu Davud, Edeb, 58/4941)





Por ja që dija e thatë nuk është e mjaftueshme. Madje, edhe nëse prindërit e bëjnë fëmijën e tyre profesor të tefsirit apo profesor të Kuranit. Nëse nuk ka devotshmëri, çdo gjë është e pamjaftueshme, sepse Islami kërkon adhurim në çdo fushë të jetës. Islami kërkon adhurim jo vetëm në një fushë, por në çdo frymë dhe në çdo hap.

Dije të thatë kanë edhe orientalistët që e studiojnë Islamin nga jashtë. Kjo dije nuk do t'u japë dobi atyre as në këtë botë, as në botën tjetër. Përkundrazi, mund t'ua shtojë edhe më shumë humbjen.

Sa bukur i shpreh nevojat tona Aliu (r.a.):

“Dija është trashëgimia më e mirë. Morali është arti më i mirë. Devotshmëria është ushqimi më i mirë. Ibadeti është kapitali më i mirë. Vepra e pranuar te Zoti është udhëzuesi më i mirë. Morali i lartë është miku i afërt më i mirë. Butësia është ndihmësi më i mirë. Të mjaftuarit me atë që kemi, është pasuria më e mirë. Meditimi rreth vdekjes është këshilluesi më i mirë.”

Përfundimisht, për çdo ditë që kalon, bota jonë vazhdimisht po ndotet nga çmenduria e jetës së dhënë pas pasioneve.

Kundërhelmi është vetëm Islami.

Shërimi i kësaj sëmundjeje është Islami i përjetuar me devotshmëri.

Profetit (a.s.), nuk i pëlqeu që sahabët të bënin muhabet hipur mbi kafshët e tyre dhe i këshilloi:

“Mos i përdorni kurrizët e kafshëve tuaja si podiume!”

(Ebu Daud, Xhihad, 55/2567)





Rrugëzgjdhja e këtij tmerri është Islami që e solli i Dërguari i Allahut (a.s.), i cili ishte mëshirë për botët.

O Zot!

**Të kërkojmë mbrojtje nga dija e padobishme!
Na jep dije të vërtetë, e cila do të jetë bazë e fortë për
ne përgjatë rrugës së marifetullahut dhe do të na e
shtojë meditimin, devotshmërinë, frikën e respektin
ndaj Teje!**

**Na e mundëso që t'ua transmetojmë brezave
tanë dijen e përsipirtshmërisë, e cila është trashë-
gimi e botës tjetër!**

Amin!..



*Njëherë, kur Pejgamberi (a.s.)
pa një fole milingonash të djegur, u tmerrua dhe tha:
"Kush e dogji këtë fole milingonash, kush mund
ta marrë jetën që ka dhënë Allahu?"*



Përmbajtja

PARAFJALË 5



NJERËZIMI KA NEVOJË PËR ATË MORAL dhe QYTETËRIM MADHËSHTOR

MORALI QË KËSHILLON KURANI.....	11
NJERËZIMI KA NEVOJË PËR ATË.....	12
MË MADHËSHTORI, MË BUJARI.....	15
MODESTIA MË E SINQERTË.....	17
FALJA MË SUBLIME.....	19
DURIMI DHE BUTËSIA E PAFUNDME.....	20
VETËDIJA E PASHOQE PËR PËRGJEGJËSINË... ..	23
MË DELIKAT SE TRËNDAFILAT, MË ORATOR SE BILBILAT.....	26
SA KEMI PËRFITUAR NE?	29



TRASHËGIMTARËT E AMANETIT TË SHENJTË

EDUKIM dhe ARSIM HYJNOR.....	37
TRASHËGIMTARËT E AMANETIT TË SHENJTË	38
SHEMBUJ NGA HISTORIA.....	40
ARGUMENTI ISLAM.....	43
QOFTË I BEKUARI.....	44
QYTETËRIMI MADHËSHTOR I INSTITUCIONEVE TË BAMIRËSISË.....	46
TË MOS CENOHEN ZEMRATI	48
MËSHIRË GJITHËPËRFSHIRËSE NDAJ KRIJESAVE.....	51
EDUKIMI SHPIRTËROR.....	52
DASHURIA HYJNORE.....	53
NJERËZIT E EDUKUAR TË NJË QYTETËRIMI TREGOJNË VLERËN E TUJ	56



HORIZONTI I NDËRGJEGJES dhe KUFIRI I NJERËZISË SONË

KA DY SY QË.....	61
PROFETI I DREJTËSISË DHE MËSHIRËS.....	63
NJERËZI EDHE NDAJ ARMIKUT	64
DITA E MËSHIRËS	66
RESPEKTIMI I KUFIJVE TË ALLAHUT.....	69
VIRTYTET E POHUARA PREJ ARMIKUT... ..	72
FITORJA E ÇANAKALASË.....	74
NJË CIVILIZIM BARBAR.....	76
LIGJI I LUFTËS NË ISLAM.....	78
MASHTRIMI I HUMANIZMIT.....	80
NË GJURMËT E KUJT JANË.....	81



VETËM DEVOTSHMËRIA...

ISLAMI: FEJA E VËRTETË	87
NJË NAMAZ ME FRIKË E RESPEKT NDAJ ZOTIT	89
NJË DIJE E TILLË QË.....	91
JO QËLLIM, POR OBJEKT PËR TË ARRITUR TE QËLLIMI.....	94
ÇËSHTJA E ISLAMOFOBISË	96
KULMI I DHEMBSHURISË.....	98
E PAVËRTETA SHQETËSOHET NGA E VËRTETA	103
BAZA SHPIRTËRORE ËSHTË KUSHT.....	105
SI SAHABËT	106

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Topbas, Osman Nûri

Qytetërimi islam / Osman Nuri Topbash; përkth.

Ilir Hoxha, Fatmir Sulaj ; red. ZijaVukaj. – Shkodër:

Progresi, 2016

110 f.; 10.5 x 20 cm.

Tit. origj.: Bizim medeniyetimiz: islam'in

cihansümul medeniyeti

ISBN 978-9928-207-06-7

1.Feja islame 2.Qytetërimi islam 3.Besimi

28 :008